

VITI XVII, NUMRI 6 / QERSHOR 2013

HUNGARY | ALBANIA | BOSNIA AND HERZEGOVINA | CROATIA | MONTENEGRO | SERBIA | SLOVENIA

FOREVER





Po ndiqja Global Rally-in e parë në Hawaii me kaq shumë distributorë të nivelit të lartë dhe një ide interesante përshkoi mendimin tim për atë që kam parë si fije të përbashkët tek këta njerëz me të cilët kam mësuar, biseduar apo punuar për gjithë këta vite: KURESHTJEN.

Njerzit që kanë kontribuar në mënyrë të veçantë në zbulimet botërore, të gjithë kanë patur një natyrë kureshtarë të pabesueshme. Albert Ainshtajn është i njohur për disa nga mendimet e tij lidhur me shpirtin kureshtar, me shprehjen e tij „Gjëja kryesore është të mos pushosh së pyeturi. Kureshtja ka arsyen e vet të ekzistencës.” Etja e tij për dije e shkencë dhe zbulimet e bëra prej tij ndryshuan botën dhe i dhanë atij çmimin Nobel në Fizikë, ndërsa revista TIME e shpalli „Njeriu i Shekullit.” Trashëgimia e Ainshtajnit për nevojën e të mësuarit dhe eksploruarit ka ndikuar thellë në mënyrën si e shohim botën.

Po ç’lidhje ka kureshtja me biznesin tonë? Zakonisht njerzit që janë të interesuar në mundësitë e Foreverit, pyesin për shkallën e shëndetit dhe mirëqënies për jetën e tyre. Ata bëjnë pyetje të tilla si: „Si mund ta kaloj kohën me familjen” apo „Ç’mund të bëj për të shtuar mjetet e mia financiare?” Këto janë pyetje të forta për ndryshimin e jetës dhe për deri sa ato janë në plan të parë në mendjen e një njeriu, ato mund të nxisin për veprime të shpejta. Ka një arsye kyçe ka deklaruar Eleonor Roosvelti: „Me lindjen e një fëmije, në qoftë se nëna tij do ti kërkonte diçka kumbares për ta bekuar fëmijën e saj, dhurata më e dobishme do të ishte kureshtja”

Gjëja që ndikon më shumë në vendimet e biznesit është ushqyerja e një sensi të fortë kureshtar tek bashkpunëtorët e skuadrës tënde. Inkurajimi i frymës kureshtarë ju jep energji për të gjetur zgjidhje krijuese dhe për të fituar njohuri të reja. Shtroji vetes pyetje të tilla:

„Si mund ta bëj këtë punë në mënyrë më efikase?”
 „Cilin lloj produkti nuk e njoh mirë me të cilën mund ti ndryshoja jetën dikujt?”
 „Cilin aspekt të planit të marketingut nuk e kam shfrytëzuar plotësisht?”

Përgjigjet e pyetjeve do të modernizojnë dhe rritin biznesin tuaj në mënyra të reja. Disa herë njerzit frenohen të bëjnë pyetje, sepse janë mësuar me rutinën e krijuar. Gjetja e një strategjie që funksionon mirë është jetike për biznesin tonë, por strategjia duhet të jetë mjaft fleksible për tu adaptuar kur ndryshojnë faktorët e jashtëm. Kureshtja mund të na ndihmojë për të eksploruar dhe përmirësuar mënyrat e punës të biznesit brenda mjedisit që ndryshon. Ju do të arrini të rrisni njohuritë për produktet, do të gjeni zgjidhje dhe rrugë më efikase që ju nuk i kishit menduar më parë. Ju dhe distributorët tuaj do të shtoni kontributin për familjet tuaja dhe për njeri tjetrin nëpërmjet ushqyerjes të frymës eksploruese në biznesin tuaj të përditshëm.

Si pjesë e familjes sonë Forever, unë ju inkurajoj të rrisni frymën kureshtarë për të arritur suksese më të mëdha në biznesin tuaj. Përfitimet nga shpirti kureshtar janë të panumurta. Sikurse e ka theksuar bukur Walt Disney: „Ne vazhdojmë të ecim përpara, duke hapur dyer të reja, dhe duke bërë gjëra të reja, sepse jemi kureshtar, dhe kureshtja na çon në rrugë të reja” Duke vazhduar të ndihmoni të tjerët për përmirësimin e shëndetit dhe të gjendjes financiare, mos harroni të bëni pyetje dhe të jeni fleksibël në metodat e punës tuaj. Së bashku ne frymëzojmë njeri tjetrin, që viti i 35 vjetorit të Foreverit të jetë një nga vitet më të mirë!

Rex Maughan
 I juaji përjetë!
Rex Maughan

FAMILJA FOREVER

Zjarri i festivitetit jeton akoma brenda nesh, sepse këto ditë përshëndetëm kompaninë mëmë, Forever Internacional me rastin e 35 vjetorit, ndërkaq akoma jeton e freskët brenda nesh festa e Ditës së Suksestit, dhe në vazhdim të saj eksperiencia jashtëzakonisht madhështore dhe e larmishme e të IV-ës Ditë Shëndeti.

Sigurisht nuk mund të lëmë jashtë festimit as Nënata tona që mbajnë solide familjet Forever, të cilat po ashtu i përshëndetëm jo shumë kohë më parë. Dhe këtu pasojnë fëmijët: në ditët e fundit të majit përshëndetëm ata, të ardhmen, të rriturit e ardhshëm, përcaktuesit e viteve që do të vijnë.

Nga përvoja kemi parë, që në shumë familje nuk punojnë vetëm nënat dhe baballarët, por edhe fëmijët, bile ata mund të jenë ndoshta më entuziastë. I shohim ata në Ditët e Suksestit, hipur në qafën e babait, aty janë kudo dhe dinë të flasin për produktet, për tabletat, bile edhe për larjen e dhëmbëve.

Foreveri ka një familje gjigande ndërkombëtare, edhe drejtorin e përgjithshëm Rex Maughan dhe Gregg Maughan i trajtojnë si antarë të familjes, së bashku festojmë, së bashku i gëzohemi sukseseve të njëri-tjetrit dhe sigurisht të bashkpuntorëve tanë. Në qoftë se ti je antarë i ri i ndërtimit të rrjetit të Foreverit, atëherë menjëherë pas antarsimit ke mundur të njihesh me këtë frymë familjare, menjëherë ke provuar, që nuk je vetëm, u shndërrohe në antar të një familje gjigande.

Është ndjenjë e mrekullueshme, të jetosh, të punosh, të marrësh pjesë në takime dhe të festosh së bashku me njerëz të buzëqeshur dhe të gëzuar. Familjet më të mëdha i drejtojnë nënat dhe baballarët më të shkëlqyer. Familjen Forever e udhëheqin drejtuesit më të mirë, Rex, Gregg dhe Aidan, ata që me bëmat, vendosmërinë dhe angazhimin e tyre na drejtojnë duke treguar shembullin e tyre. Ndërkohë që drejtojnë - këtë e bëjnë plot dashuri, dashamirësi, përzemërsi, me gadishmëri për të ndihmuar -, as nuk e vë re, që jeta jote ka marrë drejtim të mirë.

Nëse do të pranosh këshillat e sponsorit, dhe do të bësh atë, që të ka këshilluar ai, atëherë edhe ti do bëhesh pjesë e lumtur e familjes.

Këto ditë mora një ftesë nga kopshti, për ditën e baballarëve, me sa duket mendojnë edhe për ne. Jam i gëzuar, që fëmijët na festojnë edhe ne, sepse edhe ne për të ardhmen jemi, jemi për ata.

Në Forever uroj nëna, baballarë, gjyshe, gjyshër të suksesshëm si dhe shumë fëmijë të bukur e të shëndetshëm!



DR. SÁNDOR MILESZ
DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Përpara FLP Albania!



16 VJETORI LINDJESTË FLP HUNGARI

Happy 16 Birthday

BUDAPEST, 11 MAJ 2013.

DITA E SUKSEMIT GJITHMONË ËSHTË DITË FESTE, POR VEÇANRISHT SI SOT KUR KUJTOJMË 16 VJETORIN E LINDJESTË FLP HUNGARI. HUNGAREZËT DHE BASHKPUNËTORËT E RAJONIT KANË BËRË QË KY PËRVJETOR TË JETËVËRTET PËR TU KUJTUAR: REZULTATET E PREKSHMETË TYRE MUND TI SHOHIM EDHE NË FORMËN E ÇEQQEVETË CHAIRMAN'S BONUSTË SJELLA NGA GLOBAL RALLY I PARË.



Tibor Lapicz dhe bashkshortja e tij **Orsolya Lenkó Lapiczné**, edhe si sipërmarrës kanë qënë të sukseshëm, megjithatë ata i tërhoqi ndërtimi i rrjetit. Që nga ajo kohë biznesi i tyre u bë ndërkombtar. Tibori-i është një motivues i vërtetë, kjo është forca e tij. Sot së bashku drejtojnë programin e Ditës së Suksessit të ditëlindjes të FLP Hungari.

Prej 16 vjetësh në krye të FLP Hungari dhe tetë vendeve të rajonit, si drejtor i i përgjithshëm qëndron **Dr Sándor Milesz**, i cili këtë rajon e ka ngritur në nivelet më të larta të Europës dhe të botës. „Nën drejtimin e tij do të jemi edhe më të mirë – thotë çifti Lapicz, duke e ftuar atë në podium. Ndërsa Dr Sándor Milesz na kujton ato vite të shkuara, kur një ditë **József Szabó** kërkonte një drejtues për FLP e e Hungarisë. U bashkuan me këtë firmë edhe Péter Lenkey dhe bashkshortja e tij Zsuzsa, kështu filloi puna e zyrave dhe e ndërtimit të rrjeteve, pastaj „lindën“ diamantët e parë të Europës Lindore me **Veronika dhe Stevan Lomjanski**. Me radhë u hapën zyrat e rajonit nga Kroacia deri në Shqipëri, thotë Dr Sándor Milesz duke falnderuar me radhë kolegët drejtorë rajonalë. Kujton momentin kur në Hungari u titullua menaxheri i parë diamant Miklós Berkics, pastaj na përmend suksesin spektakolar të çiftit **Gidófalvi**. Bën të njohur faktin, që për xhiron në bazë frymësh popullsie, Hungaria është e para në botë, dhe „të tjerët gjithmonë kanë mësuar prej nesh“ – shprehet drejtori, pastaj na kujton fëmijët: „pa ata nuk shkon, e gjithë kjo për ata bëhet“, dhe gjithkujt i uron një ditëlindje të gëzuar, sepse suksesti këtu është i përbashkët.

József Németh „Csicsó“ dhe interpretimi nga orkestra e tij shtojnë shkëlqimin e festës, pastaj **Dr Gabriella Kassai** – menaxhere, konsulente mjekësore e FLP drejton bllokun e përvojës me produktet e FLP, domethënë atë pjesë programi ku mjekët japin përvojën sipas bindjeve të tyre mjekësore. Dr Gabriella jep garancinë e vet personale: ajo prej 50 vjetësh praktikon pediatriinë, ku mjekimin e konsideron profesionin e saj. Që nga koha kur si mjeke u njoh





me këtë firmë gjashtëmbëdhjet më parë ajo është bërë edhe një biznesmene e shkëlqyer. Ndoshta forcën e paletës të këtyre lloj produkteve, më mirë na i shprehin fjalët e **Dr Edit Révész Siklósné:** „jetëgjatësinë e njeriut e masim me numurin frymëmarrjeve, por ndonjëherë do të duhej të bëjmë edhe të tillë, nga e cila na ndalon frymëmarrja. Pra kjo është familja e këtyre produkteve – pra i përdorni ato!”

Tash e ka radhën dhënia e titujve atyre që janë në krye të karrierës-Forever: marrin distiktivët dallues supervizorët dhe asistent menaxherët. Pas kësaj, **Aranka Vágási** na tregon çfarë e ka udhëhequr „për vendimin më të mirë” dhe çfarë u këshillon atyre

që nuk kanë vendosur akoma. Pas karrierës sportive, më 1997 u përfshi në ndërtimin e rrjeteve dhe brënda një kohe të shkurtër prej 8 vjetëve ka arritur në nivelin e sotëm. Një figurë e vërtetë luftarake, filozofia e saj është: „jeta dhe familja”. Ajo këto të dyja nuk i ndan. „Familja ime është familja-Forever, madje në endrren time role kanë edhe nipërit e mbesat e mija” – thotë Aranka. „në fillim mendoja , kjo nuk është bota ime, por do të kisha marrë vendim të gabuar. Ju a jeni gati të vendosni? Mund të vendosni për objektivat tuaja? Çfarë mendoni,

kush do të ishte këtu me ju?” Sipas Aranka Vágasi , gjithshka rrotullohet rreth kohës: si e shfrytëzojmë atë. „Duhet të merresh më shumë me veten, sepse ke çdo gjë të nevojshme për zhvillimin e suksesit. Është koha jote, merr vendimin sepse Foreveri flet për ty!” Këto fjalë i vërteton me një videokasetë me përshtypje nga Hawaii.



Pastaj pasojnë tre tenorët: diamant menaxheri **Miklós Berkics**, soaring menaxheri **Tibor Éliás** dhe menaxheri **Lajos Túri-Lui** këndojnë për ne.

„Kisha dëshirë të merrja pjesë në një punë të tillë, ku të mund të jetoja e punoja për njerzit. Po të kesh paratë, nuk ka problem” – na shprehet plot gjallëri **József Szabó** duke folur për fillimet e tij.

„Deri në moshën 38 vjeç, kisha kërkuar rrugën time. Më mungonte liria, koha e lirë e jetës time. Në fillim dëgjova shumë shprehje „jo”, por më vonë përfitova shumë nga ata që u regjistruan në këtë biznes. Sigurisht edhe sot ka pikpyetje apo vështirësi, por një gjë ju këshilloj, problemet gjithmonë i trajtoni si detyra për tu zgjidhur! Ndihamoni njerzit dhe atëherë jeta juaj do të ndryshojë rrenjesisht. E vetmja mundësi e jona është tu tregojmë rrugën. Vetëm kështu riprodhohet ky biznes, pikërisht si një vrapim stafetë. Kush është ai që nuk do të dëshironte një botë më të mirë, më shumë para dhe të jetonte në liri...? Dhe më në fund vlera e vërtetë nuk do të jenë paratë, por ajo që gdhend në këtë biznes. Respekt, nderim dhe besim tek fjala jote. Sepse nga kush mund të bëhet më i mirë ky vend, përveçse nga ti?!”

József Szabó falnderon drejtorin e përgjithshëm të Ukrainës që shtë prezent në këtë eveniment, pastaj pason shfaqja e Sára Berczik e klubit të valleve të Buda-s dhe më tej jepen vlerësimet për ata që sipas planit të marketingut janë kualifikuar për +60CC, klubin e Conquistadorëve, programin stimulues, Holiday Rally dhe si menaxherë. Këtu dalin në podium për herë të parë pjesëmarrësit në Chairman's Bonus ku



Foreveri as në verë nuk
pushon. Takohemi në Ditën
e Suksesit në Budapest
më 20 Korrik, ku përsëri
mund të mësojmë nga
lektorët fantastikë!



presidenti i firmës **Rex Maughan** nga fitimi i tij ndau për më të mirët 22 milion dollar. Vetë çeku i bonusit të **Attila dhe Kati Gidófalvit** që ishin të tretët në botë ishte me vlerë afër 1 milion dollarë.

E famshme është bërë motoja e **Sándor Tóth**: „Përsa kohë të ekzistojë Foreveri, mua aty do të më gjeni”. Për leksionin emblematic sipas rrjetndërtuesit të njohur, gjithkush që dëshiron të forcohet, këtë e gjen në Forever. „Kurrë nuk kam marrë pjesë në kaq vlerësime, sa këtu” – thotë Sándori dhe pastaj na tregon se si mund të arrihet kjo. „Konkretizoji dëshirat e tua: cilat janë ato që mund të arrihen me para: për ato që ëndërron si udhëtime, mësim, mbështetje...? Hidhi në letër objektivat e tua, dhe ki besim në to! Objektivi të jetë aq i madh sa të të vërë në lëvizje për ta realizuar, por dhe aq i vogël sa mund të kesh besim se e realizon. Pse dhe si? Janë këto dy çështje themelore që të shoqërojnë në këtë biznes. Veprat flasin më shumë se fjalët, sepse ka rëndësi që të jesh shembull. Pastaj mos i harro „numerat kodik”: me 4 pikë apo si menaxher 60 pikë: ky biznes kështu funksionon. respekto nivelet, ji shembull, dije që kurrë nuk je vetëm, kërko ndihmë, planifiko, konsultohu, aftësohu, shfrytëzo mjetet, ji rezistues!

Tibor Pintér dhe shoqëria e tij vazhdojnë programin festiv, pastaj pason kualifikimi i asistent supervisorëve. Në një biznes MLM, duhet që me ndihmën e tij të ndërtojme një ekzistencë imponante, por krahas kësaj të formojmë edhe personalitetin, – një fushë e tillë ku gjithkush ka nevojë për të. **Veronika Lomjanski** – diamant menaxhere e formulon në këtë mënyrë: unë me këtë biznes munda të shpëtoj nga frika dhe turpërimi. Isha e shqetësuar si do ti edukoj fëmijët e mij, si do ti ndihmoj ata. Tani secili prej tyre ecën me këmbët e veta. Ndërsa në skuadrën time u bënë të sukseshëm ata që e kuptuan se këtu mund të sigurosh gjithshka që është e mundshme. Në qoftë se doni ti ndiqni ata, duhet që brënda vetes tju djegë dëshira dhe të kini të qartë objektivin tuaj. Nuk ka gjëra negative, në qoftë se ti nuk e konsideron të tillë. Kush është ai që nuk ka kohë për diçka? Unë jam gjithmonë qind për qind prezent, qoftë me burrin, me fëmijët apo e angazhuar me punë. Kjo ka kërkuar heqje dorë nga shumë gjëra, por kujtëdo që dëshiron të jetojë mirë, i ka siguruar mirëqenie. Mos u përtyp, por shfrytëzo mundësinë që të ofron plani marketingut. Realisht gjithkush bën atë që do, dhe askush nuk ta ka fajin, në qoftë se ti nuk do të jesh i kënaqur.”





FOREVER Dita e IV-të e Shëndetit



Muaji Maj krahas ditëlindjes të Foreverit Hungari, përkon edhe me Ditën e Shëndetit për të katërtin vit. Suksesin e aktivitetit e tregon edhe numeri në rritje i vizitorëve, si dhe më tepër se 40 eksponante. Në këtë ditë, krahas kamionëve të Programit të BE të "Kontrollit për Ruajtjen e Shëndetit", edhe firmat private kryen matje të gjendjes shëndetsore. Të interesuarit provuan mjete sportive, shijuan plotsuesit dietikë, dhe pritën konsulta për mënyrën e jetesës. Detyrat e drejtuesit të programit i kryen **Tünde Hajcsik** –senior menaxhere, **Éva Schwarz-Budai** –soaring menaxhere, dhe **Patricia Rusák**. Takimin e përbashkët tradicional të FLP Hungari dhe të Shoqatës të Mjekësisë Alternative Hungareze e hapi drejtori i përgjithshëm i FLP, **Dr Sándor Miliesz**.

Dr György Bakanek – gjinekolog, mjek specialist i pavaruri Foreverit, leksionin e tij e filloi me faktin që biologjikisht do të ishim të aftë të jetonim edhe 140 vjeç. Cilësia e jetës sonë përcaktohet nga katërshja: aftësit mendore, faktorë fizikë, nga ndjenjat dhe gjëndja shpirtërore. Ruajtja e shëndetit, kompleksi i kurimit të sëmundjeve, dhe përqsja integrative do të thotë që me resurset që kemi në dispozicion (kontrolli i përgjithshëm mjekësor, kujdesi nga mjeku, mbështetja psikologjike, ndryshimi i mënyrës të të ushqyerit, gjimnastika sistematike) të gjitha janë në shërbim të këtij qëllimi – theksoi Dr György Bakanek.



Dr Edit Révész Siklósné . mjeke specialiste e anestezisë dhe e reminacionit, soaring menaxhere, kryetare e grupit të mjekëve specialistë të Foreverit, mbajti temën për ushqyerjen e shëndetshme. Numuri i të sëmurëve nga sëmundjet karakteristike të vendeve të zhvilluara, në mbarë botën është rritur, duke u paraqitur në mosha gjithnjë e më të reja dhe duke marrë forma gjithnjë e më të rënda. Ushqyerja është ajo, që në shfaqjen e këtyre sëmundjeve mund të ndikojë dhe me ushqyerjen e duhur ne mund të bëjmë shumë për ruajtjen e shëndetit tonë. Më parë bazat e kësaj ushqyerje i përbënin llojet e drithërave, tani shkenca i ka tejkaluar këto pikpamje. Sikurse theksoi Dr Edit Révész , sot në bazën e piramidës të të ushqyerit ka zënë vend edhe konsumimi i multivitaminave dhe vitaminës D. Dieta e shëndetshme , gjimnastika sistematike dhe mospirja e duhanit në vetvete, mund të ulin deri 80% sëmundjet e zemrës, të venave dhe të diabetit të llojit të 2-të, dhe të pakësojnë 40% mundësinë e tumoreve malinje.



12 MAJ 2013. BUDAPEST



István Sági – mjek alternative na flet për aplikimin në Hungari të makrobiotikës që bazohet në 5 elementë, si Jang, domethënë tek energjia qiellore dhe Jin domethënë tek energjia tokësore që nuk shikohet, por që është prezent në tokë në qenie të gjalla dhe jo të gjalla. Njeriu është një qenie e gjallë shpirtërore ku është e rëndësishme që ti kushtohet më shumë vëmendje gjëndjes shpirtërore e frymore. Pavarësisht nga mosha, mjeku alternative rekomandon meditimn si një mundësi e prekshme për arritjen e harmonisë. Edhe një qetësim 20-30 minutash jep efektin e bekuar mbas 1-2 javësh .





Dr Terézia Samu, kirurge e venave, soaring menaxhere na flet pë mbrojtjen e zemrës dhe të sistemit të venave. Ngushtimi i venave ka disa shkaqe, ndërsa pasojat do të thotë që dobësohet funksioni dhe furnizimi me gjak i indeve që furnizohen nëpërmjet këtyre venave, duke rezultuar deri në vdekjen e indeve. Konsumimi i karbohidrateve që thithen shpejt, përdorimi i tepërt i acideve yndyrore Omega-6 rrit rrezikun e lindjes të problemeve të venave. Doktoresha thekson faktin që për ruajtjen e shëndetit në vend të dietave të ushqyerjes tradicionale të përdoren dietat e vjetra.



Ágnes Tomanó Kárászné, grafologe, na flet për rolin që luan zgjedhja e profesionit, nëpërmjet testit të vizatimit të grafikut të llojit Taraczközi. Zgjedhja e duhur e profesionit, i shërben shëndetit shpirtëror, i cili ka lidhje të ngushtë edhe me shëndetin trupor. Testi i prezantuar është një mjet i shkëlqyer për të parë mënyrën e zgjedhjes të profesionit nga struktura e të menduarit, domethënë për atë se si ndryshon mënyra e të menduarit në formë analitike, holistike, mekanike apo lineare. Tipa të ndryshëm janë të përshtatshëm për profesione të ndryshme, për shembull, ata që përdorin në mënyrë dominante trurin në gjysëm hemisferin e majtë, kanë mënyrë të menduari



Dr. Mária Hócsi, pediatre, diabetologe, menaxhere, flet për dietat e të sëmurëve nga diabeti. Rëndësia e dietës ka të bëjë me mënyrën e jetesës, si fjetja, konsumi i lëngjeve, gjimnastika dhe mënyra e të ushqyerit. Si objektiv në dietën e diabetit të tipit të 1-rë që zhvillohet në moshën e fëmijërisë është problemi i shëndetit të tepërt dhe pengimi i zhvillimit të diabetit të tipit të 2-të. Në sëmundjen të tipit të dytë objektiv i është mbajtja e peshës normale, si dhe evitimi i kthimit të komplikacioneve, ose të paktën ruajtja e niveleve.



Mária Pataki, biologe, mjeke alternative, analizon efektet positive të ngrënies të argjilës të përhapur në kulturën e disa popujve. Mineralet argjilore kanë aftësi të eliminimit të lëndëve helmuese, në sajë të vetive adsorpcuese dhe absorbuese. Konsumimi i argjilës është e përhapur në kulturën e 200 popullsive të botës, kështu psh në Amerikën e Jugut argjila e përzier me mjaltë konsumohet si embëlsirë. Edhe në botën shtazore ajo ndihmon për metabolizmin si psh tek lopët, tek papagallët apo shimpazetë, që argjilën e konsumojnë si ushqim.



Mjeku natyralist **Tibor Éliás**, soaring menaxher, na flet për magjinë e mjaltit. Futemi në botën e brëndshme të bletës, se si e përgatit ajo mjaltin nga nektari i luleve. Është një fakt për të ardhur keq që megjithë sasinë e madhe të bletarisë në Hungari, konsumi për frymë arrin vetëm 400 gram në vit, kur mjalti përmban 190 lloj lëndësh efektive dhe rrit nivelin e energjisë.



Erzsébet Pál – refleksologe, bioenergjitike, mjeshtre e reiki, në leksionin e saj flet për kurimin në një dimension më të lartë. Me trasmetimin e frekuencave të larta funksionon, kënaqësia kuruese, prekja, mendimi, uniteti, dashuria, dija, engjëjt, fati, drita e perëndisë. Në skenë paraqiten vulnetarisht pasuesit e Erzsébet Pál, me prekje kuruese trasmetojnë energji, të cilët pas "kurimit" flasin për qetësi dhe paqe të pafund.

Përshkrimi i të IV-tës Ditë Shëndeti vazhdon në numerin e ardhshëm.





CHAIRMAN'S BONUS





NIVELI 3.
GIDÓFALVI ATTILA & GIDÓFALVI KATI
BERKICS MIKLÓS
NIVELI 1.

VÁGÁSI ARANKA & KOVÁCS ANDRÁS
STEVAN LOMJANSKI & VERONICA LOMJANSKI
HALMI ISTVÁN & HALMINÉ MIKOLA RITA
TOMISLAV BRUMEC & ANDREJA BRUMEC
DR. NÉMETH ENDRE & LUKÁCSI ÁGNES
DR. SERESNÉ DR. PIRKHOFFER KATALIN
& DR. SERES ENDRE



VARGA GÉZA
& VARGÁNÉ DR. JURONICS ILONA
DRAGANA JANOVIĆ & MILOŠ JANOVIĆ
TANÁCS FERENC & TANÁCS FERENCNÉ

SIKLÓSNÉ DR. RÉVÉSZ EDIT
& SIKLÓS ZOLTÁN

SENK HAJNALKA

LAPICZNÉ LENKÓ ORSOLYA
& LAPICZ TIBOR

MÁZÁS JÓZSEF

ZSIDAI RENÁTA

HAJCSIK TÜNDE
& LÁNG ANDRÁS

MULADI ANNAMÁRIA



SARAJEVË 6 PRILL 2013

Success Day

Salla e takimit në Hotel Hollywood ishte veshur si për festë, e denjë për ditëlindjen e 12 të FLP-s së Sarajevës. Nën dritën e reflektorëve kalojnë krenarë menaxherë e senior menaxherë, bashkë me soaring menaxherët Dragana e Miloš Janović, si dhe miqtë e ardhur, Dr. Sándor Miliesz, drejtor i përgjithshëm i FLP, zafir menaxher dhe József Szabó - zafir menaxher.

Drejtues të programit në përvjetorin e dymbëdhjet të ditëlindjes ishin **Željko Glavina** - menaxher dhe **Albina Džaferović** - asistent menaxhere. Ata përshëndetën të pranishmit dhe më pas ftuan drejtuesen e zyrës së Sarajevës. **Enra Ćurovac-Hadžović** përshëndeti të ardhurit nga vendi dhe nga rajone të tjera, pastaj prezantoi shkurtimisht firmën më të mirë në botë, ose Forever Living Products-in dhe më pas thirri në skenë drejtorin rajonal të Bosnie-Hercegovinës. Dr. Slavko Paleksić përmendi sukseset dhe bashkpunimin dymbëdhjet vjeçar, pastaj ja dha fjalën drejtorit të përgjithshëm **Dr. Sándor Milieszit**, i cili nuk e fshehu gëzimin, që ndodhet përsëri në Sarajevë. Ai foli me konsideratë për zhvillimin e shpejtë dhe të suksesshëm të Sarajevës duke shprehur besimin, që edhe FLP-ja me të njëjtin dinamizëm do të zhvillohet në të ardhmen në Bosnjë.

Vaselije Njegovanović - senior manager, është distributori më i suksesshëm boshnjak për 2012-ën, fituesi i programit të makinës, ndërtesës i njohur rrjeti brenda dhe jashtë vendit foli për FLP-n e re dhe të vjetër, si dhe për rëndësinë e pjesëmarrjes së gjithë familjes në biznesin e FLP-s.

Dr. Goran Franjić mbajti leksion për produktet e reja. Ai theksoi rëndësinë e ushqimeve cilësore, pamvarësisht nga vitet e moshës, për domosdoshmërinë e konsumimit të plotësuesve ushqimorë si dhe për cilësinë e shkëlqyer të produkteve të FLP-s. Kualifikimet e reja përbëjnë hapa të mëdhaja në biznesin e FLP-s. Përshëndetëm supervisorët tanë të rinjë, distributorët më të mirë dhe fituesin e ri të programit të makinës. Të pranishmit i kënaqi me këngë gazmore dhe kërcime të zjarra grupi kulturor Igman, duke krijuar një atmosferë të shkëlqyer.

„Ndryshimi duhet të lindë vetëm brenda jush - theksoi **Dragana Janović**, soaring menaxhere - mbyllini sytë dhe përfytyroni para vetes tuaj atë, që dëshironi, pastaj filloni të punoni për të, "sepse FLP-ja është një mundësi e shkëlqyer për tu shndërruar në një biznesmen të suksesshëm dhe të pavarur."

Safet Mustafić, senior menaxher, distributori më i mirë boshnjak për 2011-ën na shpjegoi, që përse aloe vera është një bimë e mrekullueshme, sa e rëndësishme është në jetën e secilit



prej nesh, dhe përse duhet ta mbajmë në formë të përkryer veten dhe trupin tonë. Senior menaxheri hungarez, mundësi kampion **Péter Szabó** foli për rëndësinë e FLP-s në jetën e sportistëve. Ai tregoi për eksperiencat personale, si dhe për gjetjen e tij në biznesin e FLP-s.

Enra Ćurovac-Hadžović prezantoi paletën kozmetike të Sonyas, si dhe foli për rëndësinë e produkteve të FLP-s në kujdesin e trupit dhe të fytyrës. Në leksionin e saj bëri të njohur problemet e lëkurës dhe shkaqet e tyre, si dhe atë se si mund të ndihmojnë në këtë kohë FLP-ja dhe larmia e gjerë e produkteve kozmetike Sonya.

Më pas në skenë u ngjitën modele të lyera me make-up dekorativ Sonya dhe grupi muzikor **Android** i shoqëruar nga kërcimi i **Anna Hevesit**. Më e mira gjithmonë vjen në fund: këtë e vërtetoi leksioni tepër motivues i zafir menaxherit **József Szabó**. Ai foli për atë, që çelsi i të gjitha sukseseve është dëshira, njohuritë dhe përvoja - duke e ilustruar të gjithë këtë me shembuj të qartë.

Me gëzim përshëndetëm në skenë asistent supervizorët, të cilët morrën distinktivat e merituar: ata përfaqësojnë të ardhmen e biznesit tonë. Edhe njëherë falenderojmë mysafirët e ardhur nga rajonet fqinje. Shpresojmë, që do të vijjnë tek ne edhe në të ardhmen.

Shumë fat për të gjithë!

Enra Ćurovac-Hadžović
drejtuesja e zyrës së FLP-s së Sarajevës



MBRRITËN!

flawless by Sonya™

PRODUKTET E REJA DHE KATALOGU I BUKURISË!



ÇFARË MUND TË JETË MË MIRË,
SE SA TË TELEFONOSH ME ÇMIM TË LIRË?

Befaso veten
me një
telefon
të ri!

TË TELEFONOSH LIRË NGA NJË CELULAR ME CILËSI TË LARTË!

Telefoni Forever mund të arrihet vetëm nga antarët e FLP-s, krahas paketave me tarifa të ulta i favorizon klientët edhe me oferta të përzisueshme për aparatet. Tani i kemi ulur më tej çmimet e telefonave celularë!

Nga 1 korriku paketë e re Platin për të gjitha aparatet që janë me çmim më të ulët se mëparë.

Për më shumë informacione shkruaj në adresën info@forevertelefon.hu, telefono në numrin 0670-333-0-777, ose kërkoni Nikin në Nefelejcs u. 9-11!



NIVELIN E MENAXHERIT E ARRITËN



**Krisztina Vitéz Bajkánné
dhe Zoltán Bajkán**
(sponsor: Dr. Dóra Mendege)

"Ai që heq dorë nga objektivi, nuk fiton
kurrë, fituesi nuk dorëzohet kurrë."



Dr. László Jakab
(sponsor: Izabella Zachár-Szücs dhe
Zsolt Zachár)

„E arrita objektivin, tashmë duhet të
përcaktoj objektivat e reja.”



NIVELIN E ASSISTANT MANAGER-IT E ARRITËN

Baranyi Eleonora & Baranyi József
Csenkiné Darahus Éva
Ilinčić Maksim
Kuzmanović Nenad
Kuzmanović Nada
& Kuzmanović Radoje
Kuzmanović Slaven & Dimić Sanja
Mikulčić Mislav & Mikulčić Suzana
Petrović Dragica & Nikolić Zdravko
Semerédy Péter
Siljegović Dušana
& Siljegović Djordje
Stajdohar Daniel & Stajdohar Martina
Vlahović Lara



NIVELIN E SUPERVISOR-I E ARRITËN

Ács Andrea
Baliga Anita & Baliga Gyula
Barna Krisztina
Borbola Csaba József
Boris Sugar & Ewa Sugar
Brnić Tatjana & Čavrić Dario
Büki Attila & Büki Eszter
Csüllög Béla & Csüllög Béláné
Dr. Pekár-Szilágyi Csaba
& Dr. Pekár-Szilágyiné Klepács Edit
Dragas Danijel & Dragas Renata
Dubécz Marianna & Galambos István
Ferenczi Gabriella
Gubánné Laczik Éva & Gubán Róbert Éva
Hergott Tamás

Kozma Rita & Tóth Gergő
Kunstić Karmen & Baier Andrej
Mernik Helena & Mernik Saša
Németh József
Naszáli Ildikó
Parac Damir
Petrányi Bernadett
Petrovics Anett
Rigó Norbert
Skrinjar Ljerka
Szalai-Horváth Barbara & Szalai Zoltán
Szommer Julija
Tallián Krisztina & Balogh Tamás
Tengerdi Gábor Ferenc & Bordács Barbara
Todorović Ljiljana & Todorović Dimso
Todorović Branko
Todorović Miloš
Tóth Róbert Tamás
Žic Ivona



FITUESIT E PROGRAMIT MOTIVUES TË BLERJES SË MAKINËS

NIVELI 1-rë

Jožica Arbeiter & Dr. Miran Arbeiter
Becz Zoltán & Kenesei Szusanna Viktória
Bruckner András & Dr. Samu Terézia
Budai-Schwarz Éva
Marija Buruš & Boško Buruš
Csuka György & Dr. Bagoly Ibolya
Davis Erika & Davis Henry
Dr. Dósa Nikolett
Éliás Tibor
Fekete Zsolt & Ruskó Noémi
Ferencz László & Dr. Kézmárki Virág
Olivia Gajdo
Gecse Andrea
Gombás Csilla Anita & Gombás Attila
Gyurik Erzsébet & Sándor József
Hajcsik Tünde & Láng András
Heinbach József & Dr. Nika Erzsébet
Hertelendy Klára
Rinalda Iskra & Lučano Iskra
Dragana Janović & Miloš Janović
Juhász Csaba & Bezzeg Enikő
Sonja Jurović & Zlatko Jurović
Dr. Keresztényi Albert
Kis-Jakab Árpád & Kis-Jakabné Tóth Ibolya

Dr. Kiss Ferenc & Dr. Nagy Ida
Klaj Ágnes
Jadranka Kraljić-Pavletić & Nenad Pavletić
Kúthi Szilárd
Lapicz Tibor & Lapiczné Lenkó Orsolya
Mázás József
Dr. Molnár László
& Dr. Molnár-Stantić Branka
Muladi Annamária
Nagy Ádám & Nagyné Belényi Brigitta
Nagy Andrea
Vaseliye Njegovanović
Dr. Marija Ratković
Dr. Rokony Adrienne & Dr. Bánhegyi Péter
Sebők Judit
Senk Hajnalka
Dr. Seresné Dr. Pirkhoffer Katalin
& Dr. Seres Endre
Dr. Szénai László &
Dr. Szénainé Kovács Gabriella
Tanács Ferenc & Tanács Ferencné
Varga Géza & Vargáné Dr. Juronics Ilona
Varga Józsefné
Jozefa Zore
Zsidai Renáta

NIVELI 2-rë

Haim Józsefné & Haim József
Kása István & Kása Istvánné
Leveleki Zsolt & Leveleki Anita
Dr. Németh Endre & Lukácsi Ágnes
Orosházi Diána
Siklósné Dr. Révész Edit
& Siklós Zoltán
Tihomir Stilin & Maja Stilin
Utasi István & Utasi Anita

NIVELI 3-rë

Berkics Miklós
Tomislav Brumec & Andreja Brumec
Halmai István &
Halminé Mikola Rita
Herman Terézia
Krizsó Ágnes
Stevan Lomjanski & Veronika Lomjanski
Dr. Milesz Sándor
Szabó József
Tóth Sándor & Vanya Edina
Vágási Aranka & Kovács András
Varga Róbert
& Varga-Hortobágyi Tímea



BASHKË NË RRUGËN E SUKSESIT

CONQUISTADOR CLUB

04. 2013. DHJETË DISTRIBUTORËT MË TË SUKSESSHËM NË BAZË TË PIKËVE PERSONALE DHE TË NON-MENAXHERIT

HUNGARIA



1. **Dr. Jakab László**
2. **Zachár-Szűcs Izabella & Zachár Zsolt**
3. **Bajkánné Vitéz Krisztina & Bajkán Zoltán**
4. Kondi Gabriella & Kondi Péter
5. Lopiczné Lenkó Orsolya & Lopicz Tibor
6. Juhász Csaba & Bezzeg Enikő
7. Klaj Ágnes
8. Dobai Lászlóné & Dobai László
9. Varga Róbert & Varga-Hortobágyi Tímea
10. Dr. Kiss Ferenc & Dr. Nagy Ida

SERBIA



1. **Vitomir Nesic & Suzana Radic**
2. **Stevan Lomjanski & Veronika Lomjanski**

KROACI



1. **Stjepan Belosa & Snjezana Belosa**
2. **Andrea Zantev**

SLLOVENIA



1. **Rinalda Iskra & Lucano Iskra**

04. 2013.

60CG+

TË KUALIFIKUARIT

Dr. Jakab László
Zachár-Szűcs Izabella & Zachár Zsolt
Bajkánné Vitéz Krisztina & Bajkán Zoltán
Iskra Rinalda & Iskra Lučano
Beloša Stjepan & Beloša Snježana
Tanács Ferenc & Tanács Ferencné
Zantev Andrea
Varga Géza & Vargáné Dr. Juronics Ilona
Kondi Gabriella & Kondi Péter
Nešić Vitomir & Radić Suzana
Lopiczné Lenkó Orsolya & Lopicz Tibor
Juhász Csaba & Bezzeg Enikő

Klaj Ágnes
Dr. Rokony Adrienne & Dr. Bánhegyi Péter
Dobai Lászlóné & Dobai László
Varga Róbert & Varga-Hortobágyi Tímea
Dr. Seresné Dr. Pirkhoffer Katalin & Dr. Seres Endre
Dr. Kiss Ferenc & Dr. Nagy Ida
Rajnai Éva & Grausz András
Mázás József
Lomjanski Stevan & Lomjanski Veronika
Hajdu Kálmán & Hajdu Ildikó Rózsa
Éliás Tibor





Me një entuziazëm të veçantë e prisja Rally-in e 2013, takimin e parë global të përmasave botërore. Me qënë se ky ishte Rally i parë Global, mendoj se kjo nuk ndodhte vetëm me mua. Firma jonë dëshiron të prezantojë dhe dhurojë sa më shumë, prandaj është e suksesshme nga të gjitha pikpamjet.

NISJA DHE MBRITJA

Firma kujdesej për të gjithë të kualifikuarit që të mbrinin në vendin e Rally-it sa më shpejtë të ishte e mundur, gjë që flet vetë: Hawaii, lluks, shkëlqim, madhështi, vezullim, magji!

Udhëtimi i gjatë dhe lodhës ia vlen! Na pret hoteli me 5 yje, elita e Honolulit. Me pritjen e hotelit dhe mjedisi ku akomodohemi na bën ta harrojmë lodhjen. Bota bimore pralllore, bregdeti, mikpritja e njerzve, na thonë: ky është Hawaii.

Mund të shijojmë kënaqsinë e hotel Hiltonit të Hawaiian Village, që ka qënë mikpritës i njerzve me famë si Madonna, Michael Jackson, Elvis Presley, Bill Klinton... Ndërsa ne kemi fatin që në këtë hotel të mund të qëndrojmë me njerëz të tillë fantastikë si Rex Maughan dhe i biri Gregg, me Miklós Berkics, Attila Gidófalvi apo Rolf Kipp.

Si të kualifikuar, morëm pakot dhe kartat bankare që ishin përgatitur me emrat tanë për këtë Rally. Organizatorët ishin kujdesur edhe për shumë programe fakultative (psh për zhytje në det, vizitën e qytetit me helikopter, për Pearl Harbour-in) që çdo pjesëmarrës në këtë Rally të jetë pjesë e përshtypjeve të paharrueshme, sepse Foreveri pikërisht për këtë punon, për një jetë cilësore dhe për ta shijuar jetën.

Këtu secili gjeti endërrat e tija dhe mrekullitë e veta. Ndërkohë që ne argëtoheshim dhe ishim të stakuar nga puna, Rex dhe grupi i tij, po kështu edhe drejtorët rajonalë (si drejtori rajonit tonë Dr Sándor Milesz apo menaxheri i përgjithshëm Péter Lenkey) gjatë gjithë këtyre ditëve zhvillonin konferenca, për atë që ne distributorët të mund të punojmë në rrethana më komode dhe më me efektivitet, dhe për 2014 të mund të kualifikohen sa më shumë distributorë. Për distributorët, sipas edhe nivelit të kualifikimit, ishin përgatitur darka dhe pritje fantastike. Në këto pritje mundëm të njiheshim dhe miqësoheshim me bashkpunëtorë nga vende të ndryshme, të krijonim lidhje të reja miqësore, apo të takoheshim për nostalgji me miqtë e vjetër.



HAWAII GLOBAL RALLY 2013



Në mëngjezin e parë, u shpërndanë çequet e nivelit të I-rë të Chairman's Bonus, ndërmjet të cilëve edhe për mua.

Ishte vërtetë një ndjenjë mrekulluese, sepse të kualifikuarit e nivelit të parë i uruan personalisht Rex, Gregg dhe Aidan dhe ku u bënë edhe fotot e momentit!

Pastaj u titulluan distributorët, u raportua për rezultatet e arritura nga firma gjatë vitit 2012 dhe pas kësaj vazhdoi dhënia e çeqeve, por në këtë rast me grupe. Ndërkohë u argëtuam me programe të nivelit Las Vegas. Mbasdite mund të vazhdonim programe të lira secili sipas dëshirës.

Programi i detyruar ishte nga ora 10 deri në orën 14, që pastaj të mbetej sa më shumë kohë e lirë për ta kaluar në këtë vend prallor. Dita e dytë e Rally-it filloi në orën 10. U prezantuan produktet e reja të shumë pritura: koleksioni i ri „Flowless by Sonya“ për kënaqsinë e zonjave, apo seria e re e Calciumit, dy zhvillimet e reja të „Forever Dailly“ si dhe FAB-i i ri pa ndonjë ndryshim çmimi, ku pjesa më e madhe tashmë ka mbërritur edhe në rajonin tonë. Pjesëmarrësit patën avantazhin ti blejnë e provojnë në vend këto produkte të reja. Ditën e dytë vazhdoi shpërndarja e

çeqeve Chairman's Bonus për nivelin e II-të të kualifikuarve. Deri në fund të ditës u shpërndanë rreth 11 milion dollarë.

Edhe dita e tretë solli gjëra interesante, ku u prezantua zhvillimi informatikës, ndërmjet të tjerash si mund të kontrollosh më shpejt dhe më thjeshtë bonusin mujor, edhe ai që ka rrjet ndërkombtar, si dhe zhvillimi i faqes të internetit nëpërmjet të cilit mund të bëhet më i shikueshëm.



Rex Maughan mbajti fjalën e falnderimi, duke rikujtuar se si ka filluar FLP dhe prezantoi të ardhmen drejt të cilës shkojmë.

Shpalli listën e rreshtimit të vendeve sipas nivelit të shitjeve, ku rajoni ynë zinte vendin e 12-të, që është një rezultat i lartë, po të kemi parasysh se çfarë vendesh me numer popullsie të vogël e përbëjnë këtë rajon, kur në krye të listës ishin vende si India, Japonia dhe Brazili i vendit të parë!

Në fund mundëm të shikonim pjesëmarrësit e Summit-it Eagle, ndërmjet të cilëve krenarinë tonë Miklós Berkics dhe çiftin Gidófalvi.

Në garat e shitjes individuale ndërmjet më të mirëve ishin Miklós Berkics me mbi 7500 CC dhe Katika e Attila Gidófalvi me 12500 CC. Nga e gjithë bota ata u para kaluan vetëm nga dy distributorë që arritën 15000 CC: Joelle Bonnefoy e André Poli nga Franca si dhe Rolf Kipp nga Gjermania.

Mbërriti niveli i 3-të i kategorisë „mbretërit“ e Chairman's Bonus. Edhe këtu brohoritëm për dy hungarezët më të mirë, ku Rex për punën e vitit që shkoi i shpërbleu përkatsisht Miklós Berkics-in me 425,077.25 dollar, ndërsa çiftin Gidófalvi me 683,988.27 dollar. Në përfundim mësuam se takimi i Menaxherëve Eagle për vitin 2014 do të mbahet në SHBA, në brigjet e liqenit

Tahoe ndërsa Global Rally në Londër.

Këto ditë të paharruara fluturuan shpejt, dhe kjo e nxiti edhe më shumë çdo pjesëmarrës që përsëri pas një viti, të jenë fitues për Rally-in e Londrës. Çështja shtrohet a do të jeni edhe ju atje, për të shijuar këtë kënaqsi me të tjerët!

Józsi Mázás dhe Emike Váradi
Senior Menaxher Menaxher

LE TË JESH EDHE TI MENAXHER EAGLE !



PERIUDHA E KUALIFIKIMIT: 1 MAJ 2013 – 30 PRILL 2014



PËR ARRITJEN E STATUSIT TË MENAXHERIT EAGLE , MBASI DIKUSH KA ARRITUR NIVELIN E MENAXHERIT TË NJOHUR, NË ÇDO PERIUDHË KUALIFIKIMI DUHET TË KETË PLOTËSUAR KUSHTET E MËPOSHTME.

KANDIDATI...

1. Të jetë aktiv dhe të kualifikohet për bonusin e drejtuesit çdo muaj.
2. Të mbledhë gjithsej 720 pikë, nga këto të paktën 100 pikë nga distributorë të rinj të sponsorizuar personalisht.
3. Të sponsorizojë minimalisht 2 distributorë të rinj, që arrijnë nivelin e supervizorit.
4. Të mbështesë takimet lokale e rajonale.

Për kushtet e mësipërme, Senior menaxherët dhe menaxherët drejtues mbi ta, duhet të mbështesin dhe zhvillojnë menaxherët Eagle të linjës poshtë tyre, që edhe vetë të kualifikohen si menaxher Eagle (hollësitë mund ti shikoni në tabelën e mëposhtme). Çdo menaxher Eagle duhet të jetë në linjë sponsorizimi të ndryshme dhe mund të vijë nga çfardo gjeneratë.



Senior Menaxher: 1 Menaxher Eagle të linjës së poshtme



Soaring Menaxher: 3 Menaxher Eagle të linjës së poshtme



Zafir Manager: 6 Menaxher Eagle të linjës së poshtme



Diamant-Zafir Menaxher: 10 Menaxher Eagle të linjës së poshtme



Diamant Menaxher: 15 Menaxher Eagle të linjës së poshtme



Dopio Diamant Menaxher: 25 Menaxher Eagle të linjës së poshtme



Trefish Diamant Menaxher: 35 Menaxher Eagle të linjës së poshtme



Diamant Centurion Menaxher: 45 Menaxher Eagle të linjës së poshtme

PO KËSHTU:

- Kërkesat ndaj senior menaxherëve dhe atyre bashkpunëtorëve që janë mbi atë nivel , sipas të cilës duhet të figurojnë poshtë tyre eagle menaxherë – bazohet në atë që në fillim të periudhës të kualifikimit, në çfarë nivel menaxhimi ka figuruar bashkpunëtori i dhënë.
- Nga pikpamja e plotësimit të kërkesave, menaxheri i dhënë llogarit për menaxher Eagle linjën e mëposhtme që vjen nga çdo vend i huaj.
- Për plotësimin e 100 pikëve nga të rinj, menaxheri i dhënë mund të llogarit pikët e distributorëve të rinj të sponsorizuar personalisht që vijnë nga vendet e ndryshme.

Gjithë kushtet e tjera duhen plotësuar brënda kuadrit të të vetmes Zyrë Ushtrimore.

Menaxherët Eagle kualifikohen për titullin dhe marrin pjesë në një Trainim të vecantë të Menaxherëve Eagle të kualifikuar për vitin 2013.

LE TË BËHET ÇDO MENAXHER EDHE EAGLE MENAXHER!



HR

HOLIDAY RALLY

Opatija

II. PERIUDHA E KUALIFIKIMIT (01 2013.- 04 2013.) TË KUALIFIKUARIT

NIVELI I.

Illés Györgyné
Dr. Pekár-Szilágyi Csaba
& Dr. Pekár-Szilágyiné Klepács Edit
Dubécsi Marianna & Galambos István
Barna Krisztina
Vlahović Lara
Bajkánné Vitéz Krisztina
& Bajkán Zoltán
Juhász Imréné & Juhász Imre
Hajnal Attiláné & Hajnal Attila
Jécsy Gyula Lajosné
Tóth Róbert Tamás
Tátrai Csaba & Tátrai-Szűcs Beatrix
Huszai Erzsébet & Huszai Attila
Dr. Jakab László
Milosavljević Tatjana & Milosavljević Saša
Ács Andrea
Jakus Ferenc

Kozma Rita & Tóth Gergő
Petrányi Bernadett
Utasi Viktor
Boris Sugar & Ewa Sugar
Szolga Szilvia
Almási Gergely & Bakos Barbara
Merkulov Vladimir & Sojić Daniela
Meló Anita & Vasas Tamás
Hegyi László & Hegyi Dominika
Šimunić Dinko & Šimunić Sandra
Kovács-Mészáros Terézia
& Kovács Imre
Szabóné Uhrin Éva & Szabó Bálint László
Papp Sándor & Papp Sándorné
Tengerdi Gábor Ferenc & Bordács Barbara
Németh József
Tallián Krisztina & Balogh Tamás
Mernik Helena & Mernik Saša

NIVELI II.

Mogyoródi Gábor & Soós Anna
Tóth Györgyné & Tóth György
Tóth János
Bulyáki-Jenei Szilvia & Dr. Bulyáki-Jenei Sándor
Baranyi Eleonora & Baranyi József
Horváth Csaba & Horváth Csabáné
Molnár Rudolf & Molnár Ildikó
Pesling Ferencné
Molnár Ferenc & Molnárné Horváth Ildikó

Bali Ildikó & Kiss Tamás
Semerédy Péter
Schunk Mónika & Dr. Anwar Aimen
Koltai László
Pevc Aleš & Pevc-Urbančić Andrejka
Uršić Stanko & Fister Uršić Suzana
Kavecsánszki Erzsébet
Sega Marjana & Sega Anton
Jarvas Györgyi



JA VLEN TË NDJEKËSH

rrugën e paraardhësve

Sponsor: Ilona Illyés senior menaxhere

Linja e sipërme: József Szabó safir menaxher, Miklós Berkics diamant menaxher, Aranka Vágási diamant-safir menaxhere, Zsófia Gergely (dhe György Czele) senior menaxherë

Filluat menjëherë, apo për një periudhë të gjatë u miqësuar me iden e ndërtimit të rrjetit?

Éva: Nuk u menduam shumë. Në 1997-ën më kërkoi mamaja dhe më tha, që ekziston këtu një mundësi. Unë firmosa letrën, ndërsa Misi nuk u morrë me këtë punë, sepse punonte në sipërmarrjen e tij të transportit. (Mamaja ime ishte 64 vjeç kur u regjistrua në Forever, tani mbushi 78 vjeç dhe është e shëndetëshme, gazmore, e lumtur, pëlqen udhëtimet, pensioniste me të drejtë autori, senior menaxhere.)

Çfarë e zgjoi kuriozitetin tënd?

Éva: Tek ne pothuaj ishte "rutin", që të firmosnim. Përpara kësaj kishim hyrë në dymbëdhjetë rrjete, por në të vërtetë nuk kishim bërë asgjë. Ku nuk na pëlqeu drejtimi i firmës, ku vetë firmën e bënë të pamundshme, apo thjeshtë nuk u ndjemë mirë në atë mjedis. Por në vetë sistemin e MLM-s patëm besim të patundur, e dinim, që brenda saj ka forcë të madhe.

Çfarë ishte ajo, që këtu ishte ndryshe?

Éva: Bleva Lips-in, pastën e dhëmbëve, çajin, shpërblimi i parë ishte 340 forinta. Nga kjo dy gjëra ishin të sigurta: produkti është i mirë, dhe firma paguan. Ndërkohë gjithnjë e më shumë u bë e nevojshme për të ardhura të sigurta, sepse jetuam periudhën e pakos-Bokros: paraja zhvlehtësohej çdo vit me 30 përqind. Më parë kishim filluar një ndërtim, por nuk mundëm ta përfundonim shtëpinë. Unë si mësuese kisha një rrogë në bruto rreth 50 mijë forinta, ndërkohë që në dimër ngrohja shkonte 70 mijë. Bashkëshorti e la profesionin si sportist (ishte volejbollist në kategorinë e parë), sepse na duhej të fitonim më shumë para, ndërsa unë krahas orëve në shkollë jepja edhe pesëdhjet orë mësim informatike privatisht duke shfrytëzuar diplomën e dytë. Kishim mbetur aty me dy fëmijë të vegjël, dhe ndjenim, se si shkonte jeta rreth nesh.

Pra motivacioni ishte. Po cila ishte ajo që dha goditjen përfundimtare?

Éva: Erdhi një rraskapitje, kur e ndjeva, që duhet vendosur, sepse tashmë shëndeti im ishte në rrezik. Kuptova, që forca po më shteronte, nuk isha në gjendje të përballoja çdo sasi orësh, e krahas kësaj fillova të pëlqej gjithnjë e më shumë avantazhet e këtij biznesit. Fillova ta planifikoj kohën, dhe vendosa, që të nis biznesin. Personaliteti dhe përkrahja prej mentorit e György Czele dhe Zsófi Czele ishte një ndihmë e madhe në nisjen time.

**SHEMBULLI I BASHKËSHORTËVE
TREGON, SE NUK ËSHTË
PROBLEM, NËSE VETËM NJËRËN
GJYSËM "E KAP" IDEJA E
NDËRTIMIT TË BIZNESIT. "VETËM
PUNO I QETË, SEPSE BIZNESI
HERËT A VONË DO TË BËJË PËR
VETE EDHE PJESËN TJETËR TË
FAMILJES!" - KËSHILLON ÉVA
KESZI SZÉPNÉ.**





Dhe a erdhi konfirmimi?

Éva: Si jo, patjetër! Në prezantimin e parë ishin vetëm pesëmbëdhjetë vetë, dy prej tyre deshën ta fillonin menjëherë, dhe morrëm edhe një porosi prej 64 mijë forintash. Me frikë pyeta sponsorin tim, që "a llogaritet kjo si gjë e mirë?" - më tha që është shumë mirë. Brenda pesë muajve u bëra menaxhere vetëm. Misi më përkrahte shpirtërisht, dhe sigurisht edhe me atë, që kur ikja për të punuar, ai i lante enët edhe në vendin tim (atë nuk e pëlqejmë fare).

Misi, për ty sa kohë u desh, për të kuptuar, që ndërtimi i rrjetit sjell më shumë të ardhura se larja e enëve?

Mihály: Deri atëhere, sa nuk u dogj një nga kamionët tanë. Sipërmarrja ecte mirë, kamionët i blinim çdo vit, unë koordinoja rajonin e Budapestit. Por u shtuan problemet, kërkesat, dhe mua më duhej të bëja çdo gjë. Dhe pastaj erdhi ai rasti i zjarrit, në të cilin u asgjësua edhe ngarkesa me vlerë shumë milion forinta.

Éva: Këto ishin ato gozhdat në arkivolin e sipërmarrjeve tradicionale. Misi nuk kishte kurrë kohë, gjithmonë ishte i tensionuar, nuk kishim mundësi të planifikonim... praktikisht ajo sipërmarrje e bëri skllav të saj.

Mihály: Kështu që e ndërprem sipërmarrjen, dhe u futa në Forever.

Éva, ti për sa kohë e mbajte vendin e punës?

Éva: Në janar fillova biznesin, në mars dhashë dorëheqjen nga puna. Shefi më pyeti i çuditur: me çfarë do të jetosh? Por për mua atëhere nuk ishte ky piksynimi i parë.

Nuk të bëri për vete mundësia e të ardhurave?

Éva: Jo! Më mirë do të thosha e gjithë mënyra e të jetuarit. Që kur e fillova, e dinja, që kjo është e mirë. Nuk fillova në atë mënyrë, që ta provoj, por që ta bëj. Çdo ditë përsërisja parrullën time: " le të kushtojë sa të kushtojë, le të vazhdojë sa të vazhdojë, unë do ta bëj".

Si e ndryshoi organizimin e punës, ajo, që u fut edhe Misi?

Mihály: E vështirësoi. Mund të them që sfida ishte edhe ajo, që të dy së bashku të shkonim diku në kohë... sigurisht në të njëjtë kohë dha edhe shumë të mira. Jeta jonë u bë normale, po ashtu edhe ndarja e kohës, kemi mundësi të jemi bashkë, të udhëtojmë bashkë. Një çift i zakonshëm bashkëshortësh janë në gjendje të koordinojnë kohën vetëm në kurriz të diçkaje tjetër - ne kemi qënë në Amerikë mbi dhjetë herë.

Kur jeni larg, këtu a funksionon grupi?

Éva: Sigurisht. Ka ndodhur ashtu, që ne kemi ikur me pushime, dhe jemi kthyer në shtëpi me një biznes më të madh. Bashkpuntorët tanë janë njerëz të mrekullueshëm, drejtues të trajnuar mirë, ndërsa sistemi i drejtuar dhe organizuar nga linja jonë e sipërme na jep përkrahje të madhe.

Cilat janë parimet bazë në trajnime?

Éva: Sistemi mësimor i Foreverit hungarez është aq i qartë, sa nuk ishte i nevojshëm të krijonim të tonin. Ja vlen të ndjekësh parimet e përcaktuara, rrugën e paraardhësve: ne kemi punuar gjithmonë mbi këtë bazë. Shumë biznese u shkatëruan, u zhdukën si pasojë e krizës, ndërsa ne edhe sot kemi një biznes stabël, në të cilin kemi mundësi të ecim përpara. Pas senior-it erdhi niveli soaring, programi stimulues i makinës dhe udhëtimet e Amerikës: kjo tregon stabilitetin e biznesit tonë. Kështu nëse pyetja është, që a është i zbatueshëm në Forever, ndërtimi i biznesit funksionues afatgjatë, atëhere do të thosha, këtu është shembulli ynë, rezultatet e grupit tonë dhe të linjës tonë të sipërme. Ditët e Suksesit të organizuara nga dr. Sándor Miliesz japin pulsime sistematike, trajnimet madhështore të Miklós Berkicsit vendin e punës - këtu lindën materialet e mia zanore të Trajtimi i kundërshtimeve - vendosmëria e Aranka Vágásit më nxiti për përpjekje të reja, zemra e madhe e Józsi Szabós më jep gjithmonë forcë, ndërsa dashuria miqësore dhe pranuese e Zsófi Gergelyt jep për ne sigurin.



Ka ndodhur shpesh, që e ke patur të nevojshme parrullën?

Éva: Më shumë në fillim. Ndodhi, që biznesi nuk po ecte, dhe unë u dekurajova. Atëhere Józsi Szabó më kapi nga supi, dhe më pyeti, se sa fitonja më parë. I thashë që pesëdhjet mijë. Po tani sa fiton? Tetëqind. "Atëhere për çfarë po flasim? Ji e durueshme!" Kjo thënie më shoqëroi edhe për shumë kohë. Të gjithë kanë periudhë maturimi, edhe bashkpuntorët tanë, por edhe ne vetë. Edhe për ne duhej durim.

Arritët ta përfundonit shtëpinë?

Mihály: Po, edhe e shitëm. Tani jetojmë në një tjetër, ndërsa sporti u shndrrua në hobi: tani kam përsëri kohë. Edhe duhet, sepse është e rëndësishme, që nëse jemi të interesuar për një cilësi jete më të mirë, kjo duhet edhe të duket tek ne.

Éva: Misi bën sport me 35-40 vjeçarë, dhe ka rezistencë më të mirë, se ata...

Çfarë ndryshoi tek ju ndërtimi i rrjetit veç shtëpisë dhe gjendjes fizike?

Mihály: Pyetja më mirë do të ishte, se çfarë nuk ndryshoi? Kemi një stil jete të mirë, fëmijët tanë kanë shumë mundësi: Judit është 28 vjeç, ajo përparon në jetë, është ekonomiste, dhe sportiste e suksesshme në fushën e Kung Fu-s. Gergely është 26 vjeç, përgatitet në fushën e muzikës, mëson tamburin dhe këtë mund t'ja lejojë vetes krahas diplomës. Është kënaqësi, që kemi mundësi t'ju japim atyre shumë më tepër, nga çdo t'ju jepnim po të mbeteshim në jetën e vjetër.

Çfarë ju bën juve të lumtur?

Éva: P.sh. më bën jashtzakonisht të lumtur ajo, që nuk më duhet të shkoj në vendim tim të punës, nuk bie zilja, nuk rregullojnë jetën time... nga ajo kohë vetëm rinohem. Bashkpuntorët por edhe drejtuesit tanë ecin përpara duke dhënë shembull pozitiv: i vlerësojmë, që me këmbëngulje qëndrojnë këtu me ne. Shikojmë zhvillimin e njëri-tjetrit, ndihmojmë njëri-tjetrin në jetën e përditëshme si dhe në gjendjen shpirtërore, dhe kjo është e mrekullueshme. Kemi besim, që edhe ata do të arrijnë çdo gjë, që do të dëshironin! Në linjat mike gjetëm miq të mrekullueshëm. Kur takohemi

në Ditët e Suksesit, apo në evenimentet e firmës, atëhere ndjejmë gjithmonë, që jemi të rrethuar me kolegë, miq të mrekullueshëm. Nuk guxoj të mendoj, që pa mundësin e Rexit si do të ishte tani jeta jonë. Vetëm falenderime mund ti japim, për atë që arritëm deri këtu!

Për çfarë po përgatiteni këtë vit?

Éva: Tani vjen një periudhë e re. Kemi patur pesë vite shumë të vështira, kur prindërit e Misit u sëmurën. N.q.s. do të punonim në sipërmarrjen që kishim apo si të punësuar, nuk do të kishim mundësi ti ndihmonim ata. Kjo periudhë ishte shumë e keqe për ne. Tani i mbyllëm të gjitha, e shpërblyem veten, punën tonë 15 vjeçare në Forever me zgjatjen e Hawaii Global Rallyt, dhe tani do të rifillojmë. Si shembull në grupin tonë në vitet e fundit ka patur suksese, janë ngritur rezultatet e drejtuesve, para nesh përparojnë linjat tona të sipërme nën drejtimin e Miklósit, me sistemin e ri mësimor, me trajnimin Diamant, dhe kjo na jep forcë për rigjenerimin tonë.

Dhe nëse do duhet të shkoni njëherësh për leksion, kush do ti lajë enët?

Mihály: Tani enët i lan lavastovilja...



lifestyle

Këshilla për mënyrën e jetesës



Dieta e ekuilibruar dhe e përzier merr gjithnjë e më tepër theks në ruajtjen e shëndetit tonë, mbasi nëpërmjet ushqyerjes merren lëndët e nevojshme jetike për shëndetin tonë. Vallë a e kemi të qartë rëndësinë e tyre? A mund ti sigurojmë në çdo kohë lëndët ushqyese të nevojshme? Zakonet e të ushqyerit si dhe burimet e lëndëve ushqyese do të përcaktojnë, çfarë cilësie dhe jetëgjatësie do ti sigurojmë vetes.

ROLI I LËNDËVE MINERALE NË USHQYERJE

Për ruajtjen e funksionimit të qelizave dhe rigjenerimin e tyre ka nevojë për dhjetra lloj vitamina, lëndë minerale, elementë të rrallë (të gjurmës) acidra dhjamore esenciale, aminoacide dhe përzierje fitoushqyese. Gjatë ushqyerjes deficitare gradualisht shterojnë „magazinat” ushqyese të organizmit, ku pas një kohe çojnë uljen e aftësisë mbrojtëse, shqetësime funksioneve të organizmit apo edhe në probleme të funksioneve të veçanta të sistemit të organizmit.

Në këtë shkrim do të donim të tërhiqim vëmendjen në radhë të parë për rëndësinë e lëndëve minerale si dhe sëmundjet që zhvillohen më shpejt nga ushqyerja jo si duhet për shkak të mungesës të lëndëve minerale dhe të vitaminave. Këto mungesa nuk shfaqen me simptoma të menjëhershme të sëmundjeve, por ato zhvillohen gradualisht dhe pastaj vrehen kur situata rëndohet.

Le të shikojmë disa nga makro dhe mikro elementët e domosdoshëm!

BAKRI

Është i domosdoshëm për shfrytëzimin e vitaminës C dhe i nevojshëm për thithjen e hekurit, formimin e ruazave të kuqe të gjakut, ndihmon organizmin në shfrytëzimin e hekurit, rrit rezistencën dhe produktivitetin. Bakri është esencial për prodhimin e kolagenit, domethënë të proteinës bazë që gjëndet në kocka, lëkurë dhe indet lidhës. Luan rol për parandalimin e tensionit të

lartë dhe shqetësimeve të zemrës. Merr pjesë në prodhimin e melanines (lënda natyrale që u jep ngjyrë lëkurës, flokëve dhe syve) pra merr pjesë në pigmentimin natyral. Enzimata dhe përzierjet me përmbajtje bakri mbrojnë indet nga rrënjët e lira, dhe mund të ndihmojnë në mbrojtjen nga tumoret, kalcifikimet dhe sëmundjet të tjera. Është i nevojshëm për prodhimin e dismutase superoksidit, që është një nga enzimata tona antioksidante më të forta.

Simptomat e mungesës së tij janë: thinjat e parakohshme, anemia, dhe tendenca për edema, probleme të aritmisë, lodhje, probleme të fertilitetit çrregullime të sistemit të kockave, ostoporeozë, rritje e nivelit të kolesterolit (të keq) „LDL”.

ZINKU

Luan rol në aktivizimin e rreth 70 enzimave të ndryshme. Është i rëndësishëm për sintezën e insulinës, për metabolizmin e karbohidrateve, yndyrnave, proteinave dhe acidit nukleik dhe merr pjesë në një numur procesesh të organizmit. Ai gjëndet në sasira më të mëdha në sy dhe në flokë si dhe në organet seksuale të meshkujve. Sipas një studimi, kur niveli i zinkut tek fëmijët e vegjël është i ulët, atëherë shumë ngadalsohet rritja, dhe çon në prishje të oreksit dhe të shijes. Është i domosdoshëm për funksionimin normal të sistemit të imunitetit dhe në shërimin e plagëve. Ai mbron nga ftohja, gripi dhe infeksione të tjera. Ndihmon gjithashtu në simptomat kundër inflamacionit të kyçeve



dhe dhimbjes të muskujve. Ka efekt pozitiv për rregullimin e hormoneve, po kështu për rritjen produktivitetit të burrave dhe të grave. Marrja e zinkut pakëson gjithashtu zmadhimin e prostatës. Konsumimi i tij është gjithashtu me avantazhe në mosfunksionimin si duhet të tiroideve dhe të diabetit. Ai përdoret gjithashtu për probleme të ndryshme të lëkurës, ngadalson progresin e sëmundjes të verdhezës, është gjithashtu i dobishëm kundër zhurmave të veshëve, kundër osteoporozës, majasëllit dhe në rastin e inflamacionit të sëmundjeve të tjera.

Nga mungesa e tij: rritet prirja për depresion, mungesa e oreksit, lëkura e zverdhur, me njolla dhe e yndyrosur, formohen njolla të bardha tek thonjtë, zgjatet koha e shërimit të plagëve dhe krijohen probleme të mundshme me memorien.

KALCIUMI

Është lëndë minerale që gjëndet më me shumicë në organizëm. Ai luan rol tek kockat dhe dhembët, në prodhimin e disa enzimave dhe hormoneve, për komunikimin ndërmjet qelizave nervore, në koagulimin e gjakut dhe tërheqjen e muskujve. Sipas studimeve të sotme ai është i rëndësishëm jo vetëm për parandalimin e osteoporozës por ka efekt mbrojtës për tensionin e lartë të gjakut, si dhe kundër formimit të tumoreve të zorrës së trashë. Kalciumi në zorrë neutralizon acidrat e tëmthit, duke penguar kalimin e tyre në zorrën e trashë, e duke pakësuar kështu rrezikun e zhvillimit të tumoreve. Efekti i tij duket më tepër kur merret bashkë me vitaminat A, C e D si dhe me hekurin, magneziumin dhe fosforin. Niveli i kalciumit në gjak është i qëndrueshëm dhe në qoftë se ulet niveli i tij, atëherë ai kompensohet nga kockat, duke çuar kështu në zhvillimin e osteoporozës. Me qënë se kalciumi, konsumohet çdo ditë me urinimin atëherë edhe për plotësimin e tij duhet të kujdesemi vazhdimisht.

Mungesa e tij: çon në zhvillimin më të shpejtë të osteoporozës e të ngërçeve të muskujve si dhe në rritjen e rrezikut të tensionit të lartë.

HEKURI

Me ushqimet e konsumuara, në fakt thithet vetëm rreth 8-10% e hekurit. Thithja e tij parandihmon prezencën në sasinë e duhur të vitaminës C në ushqim dhe në organizëm dhe është i nevojshëm për përbërjen dhe sasinë e duhur të probiotikëve në zorrë. Është i domosdoshëm për formimin e gjakut, për hemoglobinën, për ngjyrën e kuqe të muskujve dhe mioglobinën si dhe për krijimin e disa enzimave. Ai ndihmon rritjen, rrit rezistencën, parandalon lodhjen, përmirëson aftësinë përqëndruese dhe pakëson preken nga infeksionet. Gratë me barrë dhe ato që kanë fëmijë në gj, kanë nevojë për trefishin e sasisë që kanë nevojë të tjerat.

Simptoma të mungesës të tij janë: anemi e sheshtë, lodhje, vështirësi frymëmarrje, shtim i rrahjeve të zemrës dhe prirja më e lartë për marrjen e infeksioneve.

MAGNEZIUMI

Magneziumi është i nevojshëm për ekuilibrin normal të kalciumit, natriumit, kaliumit e fosforit, si dhe për efektivitetin të vitaminës C. Niveli i duhur i magneziumit, krahas pakësimit të rrezikut të infarktit të zemrës, ul tensionin, zgjeron venat koronare dhe pakëson rrezikun e aritmisë të zemrës. Marrja në sasinë e duhur e magneziumit mund të parandalojë diabetin e pleqërisë. Lehtëson simptomat e padëshiruara të paramenstruacioneve dhe ngërçet e menstruacioneve dhe luan rol të rëndësishëm në parandalimin e osteoporozës pas menopauzës. Sipas disa studimeve ai është një element i rëndësishëm në shkrirjen e ngërçit të bronkeve dhe si një plotësues për migrenën. Është i nevojshëm për reaksionin e mbi 300 enzimave. Efekti i tij duket bashkë me vitaminat A dhe D, si dhe me kalciumin e fosforin.

Nga mungesa e tij: janë më të shpeshta nervozizmi, iritimi, spazmat e lehta, ndjenja e lodhjes apo probleme të gjumit dhe dhimbjet e kokës.

MANGANI

Mangani luan rol të rëndësishëm për efektivitetin e biotinës, vitaminës B1 dhe C dhe aktivizimin e enzimave të nevojshme. Është gjithashtu i rëndësishëm për strukturën normale të kockave dhe formimin e hormoneve të gjëndrave tiroide. Ka rëndësi për shumëzimin normal, dhe funksionimin pa difekte të sistemit nervor qendror.

Mungesa e tij: shpesh çon në dhimbjen e kyçeve (kryesisht të gjunjëve), rënie të fikët, probleme dëgjimi dhe humbje të ekuilibrit.

MOLIBDENI

Ndihmon në metabolizmin e karbohidrateve dhe yndyrnave dhe është pjesë e domosdoshme e enzimave të duhura për efektivitetin e hekurit.

Simptoma të mungesës të tij janë: aritmi e zemrës, vështirësi frymëmarrje, probleme të shikimit.

SELENI

Ka efekt antioksidant, ngadalson plakjen e qelizave, zbut valët e të nxehtit gjatë menopauzës të grave, pakëson gjëndjen e përgjithshme të mërzisë. Rrit raportin e nivelit të kolesterolit HDL („të mirë”) duke siguruar kështu një mbrojtje ndaj sëmundjeve të zemrës dhe të sistemit të venave. Bashkë me to rrit efektin e vitaminave E, C dhe A. Mungesa e tij ul aftësinë e rezistencës të organizmit, prandaj dhënia e tij rekomandohet kundër infeksioneve të viruseve, herpesit të gojës dhe pakësimit të psoriasisit. Është e provuar se siguron mbrojtje ndaj disa tumoreve (si të prostatit, zorrës së trashë,

lifestyle



zorrës të jashtëqitjes, kancerit të mushkrive, të vezoreve, të qafës së mitrës, të pankreasit, kancerit të mëlçisë dhe leucemisë. Merr pjesë në ndërtimin e një enzime me efekt antioksidanti (glutation peroxidaz), e cila pengon efektin dëmtues të molekulave DNS të rrënjëve të lira. Në sasia më të mëdha grumbullohet në veshka, mëlçi, pankreas, tiroide dhe testikula, megjithatë e përmbajnë të gjitha qelizat e trupit.

FOSFOR

Është gur lidhës për disa proteina, enzima apo acida nukleike. Luan rol të rëndësishëm në rregullimin e efektit të proteinave, karbohidrateve, metabolizmin e yndyrave dhe rregullimin e efektit të kemioterapisë. Është i nevojshëm për funksionimin e sistemit nervor, për forcimin e kockave dhe të dhëmbëve, çdo qelizë ka nevojë për të. Luan rol në ndërtimin e membranës që rrethon qelizat dhe merr pjesë në trasmetimin e informacionit brënda dhe ndërmjet qelizave. Fosfori është i domosdoshëm në tërheqjen e përgjithshme të muskujve, në trasmetimin e impulseve nervore dhe në seksrecionin e hormoneve. Rastet e mungesës të fosforit janë të rralla.

JODI

Në sasia më të mëdha mund të gjendet në tiroide, është pjesë organike e hormoneve të tiroideve, duke marrë pjesë në rregullimin e metabolizmit, ndikon në rritjen dhe funksionimin e sistemit nervor, në shumëzimin dhe funksionet e organeve lëvizëse, rregullon rritjen e thonjeve dhe të flokëve dhe shfrytëzimin e oksigjenit nga qelizat. Nga mungesa e tij, ngadalsohet metabolizmi i lëndëve, thahet lëkura, shfaqet sindroma e thyerjes të flokëve si dhe zmadhohen tiroidet.

Simptoma të mungesës të jodit janë: Mungesa e jodit ndikon në aftësinë lëvizëse, ulet aftësia reaguese, ngadalsohen duart, aftësia koordinuese dhe forca e muskujve.

VANADIUMI

Është i nevojshëm në sasia shumë të vogla. Merr pjesë në funksionimin e disa enzimave, në rregullimin e metabolizmit të karbohidrateve dhe yndyrave, ndihmon efektin e insulinës, pakëson nivelin e kolesterolit në gjak, ndihmon rritjen e masës të muskujve.

Megjithatë lëndët minerale në tërësinë e tyre përbëjnë vetëm 4-5 % të organizmit, ato janë të domosdoshme për një jetë të shëndetshme, mbasi si katalizatorë rregullojnë shumë procese jetikë si për shembull për funksionimin e sistemit të imunitetit, formimin e gjakut, prodhimin e energjisë, rregullimin e hormoneve dhe ekuilibrin bazë-acide. Sasi më të madhe të lëndëve minerale përmbajnë frutat e zarzavatet, prandaj duhet të synojmë gjithnjë e më tepër në këto dieta të përziera dhe të ekuilibruara, që i përgjigjen moshës dhe mënyrës të jetesës. Për fattë keq, për shkak të veprimtarisë të zhvillimit të bujqësisë intensive është pakësuar përmbajtja e lëndëve minerale tek bimët dhe njerzit rrallë konsumojnë 3-5 herë në ditë ushqime me zarzavate. Aktualisht karakteristike është konsumi i ushqimeve të përpunuarasi dhe ushqyerja e njëanshme. Por esenciale nuk është vetëm sasia për këto lëndë por edhe raporti relativ midis tyre, gjë që është e vështirë të sigurohet dhe kështu rritet rreziku nga mungesa e tyre.

Duke patur parasysh gjithë këto mund të thuhet se për një jetë të shëndetshme bëhet i nevojshëm kompensimi i lëndëve minerale në formën e plotësuesve dietikë. Nga pikpamja e rëndësisë janë njëlloj përbërja, cilësia dhe sasia e duhur. Nga ana tjetër ka rëndësi që të dihet në ç'masë përmbahen lëndët minerale dhe si janë ato të lidhura me njëra tjetrën nga pikpamja molekulare.



Dr. Ibolya Bagoly
Oxyologe dhe e specializuar
si mjeke familje

LITERATURA:

- MSD Orvosi kézikönyv Melánia Kiadó 1994
- Elődi Pál: Biokémia Akadémia Kiadó 1989
- Dr. Polgár Marianne: Vashiányos anémia és kognitív fejlődés Gyermekorvos Továbbképzés 2011.10. évfolyam 4.szám
- Endre László dr.: A cink szerepe a hormonokban Gyermekorvos Továbbképzés 2011.10. évfolyam 3. szám
- prof. Dr. Balázs Csaba: 12 kérdés a pajzsmirigy működéséről és betegségeiről
- prof. Dr. Péter Ferenc. az MTA doktora: Amit a jódról és a pajzsmirigyéről tudnunk kell
- Vitaminok, gyógynövények, ásványi anyagok Reader's Digest 2000



ARANKA VÁGÁSI, DIAMANT-ZAFIR MENAXHERE

Për zhvillimin tim personal një përvojë vendimtare për punën kam patur nga leximi librave. Të thuash cili ka qënë libri më i mirë nuk është e lehtë, sepse gjatë 20 vjetëve janë të panumurt librat që kanë ndikuar në cilësinë e punës time.

Dale Carnegie: Si të jesh i Sukseshëm – Shkolla amerikane e karrierës Përvojën e parë e kam nga libri i Dale Carnegie: Si të jesh i sukseshëm – Shkolla amerikane e karrierës, që tek unë tek unë krijoi një përmbajtje specifike për mundësitë e pakufizuara të individit. E kam kthyer tek vetja ime dhe çdo ditë e kam parë të dobishëm.



ÉLIÁS TIBOR: LIBRI I MJALTIT

Shkolla e Foreverit bazohet tek njohja me themel dhe dashuria për produktet. Për këtë një ndihmë të madhe më ka dhënë „Libri i Mjaltit” i Tibor Éliás, në të cilin gjen informacion për produktet e bletës, për mjaltin, polenin, propolisin dhe qumështin e bletës. A e dini që këto janë lëndët ushqyese më të rëndësishme për njeriun? A e dini pse produktet e bletës të Foreverit janë më të mirat?! Mund ta mësoni po të rilexoni disa herë këtë libër dhe mësimet e tij ti zbatoni në jetën e përditshme.

ANDOK FERENC: MLM - JETË E PASUR

Është një manual didaktik i sistemit MLM, me qasje inovative në fushën e zhvillimit të personalitetit. Materialin duhet ta rilexosh disa herë, që të hysh në përmbajtjen reale të tij. Për shembull: „Njeri i madh është ai që është në gjendje që vlerat e tij ti përdorë në mënyrë të kulturuar dhe ti ndajë edhe me të tjerët.” Si mund të shkëlmosh pengesat, mbasi ke mundur të realizosh dijet e tua për MLM? Të mund ta shfletosh çdo ditë këtë libër dhe përmbajtjen e tij tia përshtatësh jetës tënde..



BRIAN TRACY: PUTHE BRETKOCËN!

Shikoje monopatin – në çdo të keqe ka diçka të mirë. „Puthe bretkocën!” thotë Brian. Është e vështirë ta trajtosh bretkocën në këtë situatë sepse për shumë vite njerzit e kanë ngulitur në kokë, gëlltite dhe prano fatin. Njeriu i suksesshëm praktikon pranimin: shikon me guxim në sy bretkocën, dhe ballafaqohet me problemet. Punën dhe jetën i shikon dhe ndërton në mënyrë pozitive. Mekanizmi i veprimit të shkopit magjik është në dorën tënde, në qoftë se e lexon disa herë përrallën e bretkocës.

Si përfundim mesazhi im është ky: në qoftë se ke planin „A” dhe i ke vënë jetës për detyrë, por të duket se nuk mund ta realizosh, dhe je gati të dorëzohesh, atëherë mba gati planin „B” që nuk është gjë tjetër veçse zbatim i planit „A”!

NJOFTIME TË ZYRËS QËNDRORE

Me zyrat tona mund të lidheni në faqen e Internetit të distributorit në adresën www.foreverliving.com duke klikuar „FORGALMAZÓI BEJELENTKEZÉS”- (Për tu futur në të duhet passwordi dhe emri i përdoruesit, të cilat mund ti siguron duke dërguar një e-mail tek qendra e informatikës me adresë: it@flpseeu.hu. Këtu mund të gjeni informacion për gjëndjen e pikëve, për blerjen me internet dhe për llogaritjen e bonusit mujor. Këtu mund të gjenden gjithashtu materiale marketingu, revista mujore, ditari aktivitetesh, përshkrimi i programeve stimuluese, materiale që mund të shkarkohen nga interneti, materiale trainimi, katalogë, politikën e biznesit të FLP et. Kanale tona YouTube, mund ti gjeni në adresën www.youtube.com/user/AloePod



HUNGARIA

Drejtoria Qëndrore Budapest: 1183 Budapest, Nefelejcs u. 9-11.
E-mail: flpbudapest@flpseeu.hu Tel.: +36-1-269-5370, +36-70-436-4288, -4289, +36-1-297-1995 Me korespondencë me letër: 1439 Budapest, Pf.:745.
Drejtori përgjithshëm: Dr. Sándor Milesz: +36-1-297-1995, mobil: +36-70-316-0002
Drejtoreshë e Marketingut dhe e Komunikimit: Bernadett Huszti: ext:194, mobil: +36-70-436-4212;
Dóra Harman: ext: 157, mobil: + 36 70 436 4197
Zsuzsanna Petrőczy: ext: 131, mobil: +36-70-436-4276
Derjtoresha e shitjeve dhe e zhvillimit: Erzsébet Ladák: tel.: +36-1-269-5370/ ext.160, mobil: +36-70-436-4230;
Seksioni i komunikimit ndërkombëtar: Aranka Szecsei: ext. 136, mobil: +36-70-436-4229; Ottília Csábrádi: ext. 135, mobil: +36-70-436-4227
Seksioni i Marketingut dhe Trainimit (FLP TV): Sándor Berkes, ext. 133, mobil: +36-70-436-4213

Qendra e Trainimit: 1067 Budapest, Szondi utca 34., tel.: +36-1-332-5956, +36-70-436-4285, +36-1-373-0025, fax: + 36-1-312-8455
Prenotimi sallës/ informacioni: Bálint Rókás mobil: + 36 70 436 4280
Hapur: H-P: 10.00–21.00

Qendra e Trainimit SONYA Koordinimi i kohës: Veronika Kozma - kozmetiste: +36 70 436 4208; Melinda Ésik - parukere : +36 70 436 4178
Skonto shërbimi: me 10 herë 10%, me 5 herë 5%
TRAINIM FALAS në Qendrën e Trainimit Sonya! Në rrugën Szondi, të martën ora 10, në qendrën Sonya në rrugën Nefelejcs, të enjten ora 15. Lidhuni me telefonin e Foreverit: Kata Ungár 30-331-1883.

POROSI PRODUKTESH

Produktet mund të blehen personalisht në zyrat tona ose mund të porositen:
-Me telefon celular: +36-70-436-4290 dhe +36-70-436-4291 ose telefon fiks +36-1-297-5538 dhe +36-1-297-5539 të hënën nga ora 8-20 ; të martën deri të premten nga ora 10-20, në tel.cel:+36-70-436-4294 dhe +36-70-436-4295, të hënën 12-20, ditët e tjera : nga 10-18 si dhe gjatë ditëve të punës gjatë javës mund të kërkonin nga 12-16 në telefonin jeshil pa pagesë +36-80-204-983.
– dyqani me Internet: www.foreverliving.com, ose www.flpshop.hu.
Shërbimi klientit:
WEBSHOP: + 36-22-333-167, +36-22-500-020, +36-70-436-4286, webshop@flpseeu.hu
TELECENTER: +36-70-436-4290, +36-70-43-4291, +36-1-297-5538, +36-1-297-5539, telecenter@flpseeu.hu
Shefe e shërbimit të klientit: Malik Melinda, cel: +36-70-436-4240
Produktet e porositura me telefon ose internet ju sillen në shtëpi brënda dy ditëve, me shërbimin korier, në kohën e rënë dakort. Për vlerat e faturave me 1.00 CC e lart shpenzimet i përballon firma.
Produktet e Forever Living Products distribuohen me rekomandimin e Shoqatës Hungareze të Mjekësisë Alternative.

RISHITJA E PRODUKTEVE DHE REKLAMA Produktet dhe materialet tona të marketingut është e ndaluar të rishiten në internet. Ato mund të ekspozohen dhe shiten në dyqane dhe zyra në bazë të pikave 16.02 (h), (i), (j) dhe (k) të politikës së FLP. Rregullat që kanë të bëjnë reklamën dhe përgatitjen e faqes personale të internetit që lidhen me veprimtarinë e distributorit mund ti gjeni në pikat 16.02. (h), si dhe 17.10 të Politikës të FLP. Për të DHËNAT E XHIROS mund të interesohi si më poshtë:

– në internet: në pjesën e distributorit të faqes: www.foreverliving.com,
– në softverin Forever Telefon, – me shërbimin internet MyFLPBiz,
– dhe qendrat tona: për partnerët e Hungarisë në numerat telefonik: +36-1-269-5370 dhe +36-1-269-5371 ndërsa për vendet e tjera të rajonit tonë në: +36-1-332-5541. +36-1-269-5370 dhe +36-1-269-5371, kurse nga shtetet e tjera të rajonit në numrin +36-1-332-5541.

Drejtoria Operative: 1183 Budapest, Nefelejcs u. 9-11. Tel.: +36-1-269-5370, +36-70-436-4288, -4289

Derjtori i Përgjithshëm i Menaxhimit: Péter Lenkey: cel: +36-70-436-4292
Asistente: Mónika Vékás-Kovács: ext. 192, cel: +36-70-436-4281
Derjtoresha e Financës: Gabriella Rókásné Véber: tel.: +36-1-269-5370/ ext. 171, Cel: +36-70-436-4220
Shefe e financës: Katalin Blahut Botosné: ext. 121, Cel: +36-70-436-4218
Derjtori i Kontrollit: Zsolt Suplicz: tel.: +36-1-269-5370/ ext. 181, Cel: +36-70-436-4194,

Derjtoria e Rajonit të Debrecenit: 4025 Debrecen, Erzsébet u. 48. Tel.: +36-52-349-657, fax: +36-52-349-187 Hapur: Hënën: ora 12-20, të martë-premtë: 10-18 (mbyllja e faturimeve 30 minuta para mbarimit të punës)
Derjtori Rajonal: Kálmán Pósa: Cel: +36-70-436-4265

Derjtoria Rajonale e Szegedit: 6721 Szeged, Tisza Lajos krt. 25., Tel.: +36-62-425-505, fax: +36-62-425-342 Hapur: H: 12-20, M – P: 10-18 (mbyllja e faturimeve 30 minuta para mbarimit të punës)

Derjtori Rajonal: Tibor: Radóczy

Derjtoria Rajonale e Székesfehérvárit: 8000 Székesfehérvár, Sóstói út 3. Tel.: +36-22-333-167, +36-70-436-4286, +36-22-500-020, fax: +36-22-503-913 Hapur: H: 12-20, M– P: 10-18 (mbyllja e faturimeve 30 minuta para mbarimit të punës)

Derjtor Rajonal: Tibor Kiss.

Forever Resorts

Teleki-Degenfeld Kastélyszálló, Szirák, 3044 Szirák, Petőfi u. 26., tel.: +36-32-485-300, fax: +36-32-485-285 www.kastelyszirak.hu
Restoranti Sasfészek, tel.: +36-1-291-5474, www.sasfeszketterem.hu.
Derjtoresha e Resortave të Foreverit në Hungari Katalin Király.
Zyra Phoenix për prenotim bileta avioni Szondi u.: H-P: 12.00-18.00, Gabriella Pittmann +36 70436 4297

Mjekët tanë specialistë:

Dr. Edit Révész Siklósné, kryetare e Mjekëve Specialistë të Forever Hungari,
Dr. Gabriella Kassai: 70/414-2335; Dr. László Mezősi: 70/779-1943;
Dr. Endre Németh: 70/389-1746; Dr. Terézia Samu: 70/627-5678,
Mjek specialist i pavarur: Dr. György Bakanek: 70/414-2913
Mund të thirrren gjatë orarit të punës.

KALENDARI AKTIVITETEVE: Budapest, Success Day: 17 nëntor dhe 15 dhjetor 2012.

Orari mbajtjes hapur të Qendrës në rrugën Nefelejcs:
H: 08.00-20.00, M-M-E: 10.00-20.00, P: 10.00-18.00
Telecenter: H: 08.00-20.00, K-SZ-CS-P: 10.00-20.00
Në ditët e javës të fundit të muajit mbahet hapur 08.00-20.00, ndërsa të shtunën e fundit të muajit (kur nuk pasohet nga ditë jave) 12.00-20.00.

PROGRAMI TRAINIMIT VJETOR 2013

DITË SUKSESI: 20 korrik, 16 nëntor;

TRAINIME 2 DITOR: 8-9 qershor, 12-13 tetor

PROGRAMET STIMULUESE

15-22 shtator trainimi Go Diamond, 4-5 tetor Holiday Rally

NJOFTIME



SERBIA

Zyra e Beogradit: 11010 Beograd, Kumodraška 162.
tel.: +381 11 397 0127, Fax: +381 11 397 0126,
e-mail: office@flp.co.rs
Dërgimi porosive: narucivanje@flp.co.rs
Hapur: e hënë, e martë, e enjte: 12.00–19.30,
Të mërkurë dhe të premte 09.00–16.30,
Çdo të shtunë të fundit të muajit dhe në ditët e Suksesit
9.00–12.30 Telecenter: +381 (0) 11 309 6382
Salloni i Bukurisë Sonya: 063/394 171

Zyra e Nishit: 18000 Niš, Učitelj Tasina 1/3, Tel: +381 (0) 18
514 131; Fax: +381 18 514 130, e-mail: officenis@flp.co.rs
Hapur: e hënë, e martë, e enjte: 11.00–19.00
Të mërkurë dhe të premte 09.00–17.00,
Çdo të shtunë të fundit të muajit dhe në ditët e Suksesit
9.00–12.30

Zyra Horgosi: Tel/fax: +381 (0) 24 792 195,
e-mail: tinde.szolnoki@flp.co.rs
Hapur: nga e hëna deri të premten: 8.00–16.00.
Çdo të shtunë të fundit të muajit: 9.00–12.30.

Drejtor rajonal: Branislav Rajić
Mjekët Specialistë: Dr. Biserka Lazarević
dhe Dr. Predrag Lazarević: +381 23 543 318

Success Day: 27 janar, 24 mars, 19 maj, 23 qershor
29 shtator, 24 nëntor



MALI I ZI

Zyra e Podgoricës: 81000 Podgorica,
Serdara Jola Piletića 20.,
tel: +382 20 245 402 fax: +382 20 245 412
Hapur: të hënë: 12.00–20.00
Ditët e tjera të punës: 9.00–17.00
Çdo të shtunë të fundit të muajit, hapur nga 9.00–14.00

Drejtori Rajonal: Aleksandar Dakić
Mjeku specialist: Dr. Laban Nevenka: +382 69 327 127
flppodgorica@t-com.me



SLLOVENIA

Zyra e Lubljanës: 1236 Trzin-Ljubljana, Borovec 3.
tel.: +386 1 562 3640, fax: +386 1 562 3645
Porosi e produkteve: Cel: +386 40 559 631,
tel: +386 1 563 7501
Porosi me e-mail : narocanje@forever.si
Informacione me e-mail : info@forever.si
Hapur: hënë 12.00–20.00, të martën deri të premten
9.00–17.00

Zyra e Lendvai: 9220 Lendava, Kolodvorska 14.
tel.: +386 2 575 12 70, fax: +386 2 575 12 71
Hapur: të hënë deri të premten 9.00–17.00
e-mail: lendva@forever.si
Drejtori Rajonal: Andrej Kepe
mjeku specialist: Dr. Miran Arbeiter: +386 41 420 788
Success Day: 23 mars, 18 maj, 28 shtator, 23 nëntor
Trainime: Leksione të hapura çdo të mërkurë: nga ora 19.00,
Draš Center, Maribor, Pohorska 57.



KROACI

Zyra e Zagrebit: 10000 Zagreb, Trakošćanska 16.
tel: +385 1 3909 770; Fax: +385 1 3909 771
hapur: të hënë dhe të enjte: 09.00–20.00,
të martën, mërkurën dhe të premten 09.00–17.00

Zyra e Rjekës: 51000 Rijeka, Strossmayerova 3/A
tel: +385 51 372 361, +Cel: +385 91 455 1905
Hapur: të hënë dhe të enjte: 12.00–20.00,
të martën, mërkurën dhe të premten 09.00–17.00
Drejtor Rajonal: Dr. Molnár László
Mjekët specialistë: Dr. Ljuba Rauški Naglič: cel: +385 91 51 76 510
Dr. Draško Tomljanović: cel: +385 91 41 96 101
të martën 14.00–17.00 dhe të premten 14.00–16.00
Trainime: në Zagreb, Trakošćanska 16., të hënë dhe të mërkurën
18.00–19.00
në Rijeka, Strossmayerova 3/A, të hënë dhe të enjte: 18.00–19.00
flp-zagreb@zg.htnet.hr

Success Day: 23 mars Zagreb, 18 maj Opatij, 19 tetor Opatij– Hotel Adriatik



SHQIPËRIA

Zyra e Tiranës: Zyra e Tiranës: Tiranë, Reshit Çollaku 36.
Tel./Fax: +355 42230 535
Hapur: ditët e punës 9.00–13.00 dhe 16.00–20.00
Drejtor Rajonal: Attila Borbáth
cel: +355 69 40 66 810, +36 70 436 4293
Shef Zyre: Xhelo Kiçaj: Cel: +355 69 40 66 811,
cel: +36 70 436 4310,
e-mail: Flpalbania@abcom.al



KOSOVA

Zyra e Prishtinës: Prishtinë Rr. Azem Hajdari br. 32.
tel.: +377 44 50 3911
hapur gjatë ditëve të punës: 10.00–16.00.
Derjtor rajonal: Attila Borbáth
Cel: + + 355 69 40 66 810

flpkosova@kujtesa.com



BOSNJE-HERCEGOVINA

Zyra e Bijeljinas: 76300 Bijeljina, Trg D. Mihajlovića 3.
tel.: +387 55 211 784, +387 55 212 605, fax: +387 55 221 780
Hapur gjatë ditëve të punës 9.00–17.00
Derjtor rajonal: Dr. Slavko Paleksić

Zyra e Sarajevos: 71000 Sarajevo, Džemala Bijedića 166 A.
tel.: +387 33 760 650, +387 33 470 682, fax: +387 33 760 651
Hapur: të hënë, enjte dhe të premten 09.00–16.30,
të martën dhe të mërkurën: 12.00–20.00
Shef Zyre : Enra Curovac-Hadžović
forever.flpbos@gmail.com,

Success Day: 1 qershor Sarajev, 7 dhjetor Bijeljin

FOREVER



Menaxherja 38 vjeçare që jeton në Vac ka mbaruar teknikumin për ekonomi. Bashkë me bashkëshortin edukojnë katër fëmijë, më i vogli gjashtë dhe më i madhi pesëmbëdhjet vjeç.
Sponsor: Dr. Dóra Mendege, Linja e sipërme: Dr. László Jakab, Izabella Szűcs Zachár dhe Zolt Zachár, Éva Schwarz-Budai, Zolt Fekete dhe Noémi Ruskó, Zolt Leveleki dhe Anita Leveleki, Terézia Herman, László Juhász, Zoltán Becz, Zsófia Gergely, Aranka Vágási dhe András Kovács, Miklós Berkics, József Szabó, Rolf Kipp, Rex Maughan

FOREVERI MË DHA ËNDRRA TË REJA

KRISZTINA VITÉZ BAJKÁNNÉ
MENAXHERE

Pyetja është e pashmangshme: kur je takuar për herë të parë me Foreverin?

Me mundësin e biznesit kam filluar të merrem prej dhjetë muajsh, ndërsa produktet familja i përdor prej njëmbëdhjet vjetësh. Për herë të parë biznesi më gjeti para katër vjetësh, por atëhere fëmija im më i vogël ishte vetëm dy vjeç, prandaj mbetëm në atë, që unë nuk kam mundësi. Vjet në verë u takova me Izabella Szűcs Zachárin, e cila organizoi grupin në lagjen tonë, dhe më ofroi, që edhe unë të jem një nga lojtaret e grupit. Kështu si biznes filloi vjet në korrik.

Cilat ishin përvojat e para?

Si dhuratë nga linja ime e sipërme shkova në Poreç, i cili më dha një shtytje shumë të madhe.

Çfarë të bëri që një nënë me katër fëmijë, të filloi një karrierë të re, sepse edhe si nënë mund ta kishe përmbushur jetën tënde?

Kjo është e vërtetë, dhe unë ja dola mbanë. Pas një periudhe të gjithë filluan të më pyesnin menjëherë, se çfarë do të bëj, kur të largohen fëmijët. Foreveri mu duk si mundësi e mirë, që të mos jem „vetëm” nënë me katër fëmijë. Vlerësimi që marr këtu është i rëndësishëm, dhe edhe ajo, që të jem ndihmë për bashkëshortin, që të mos jetë vetëm përgjegjësia e tij për sigurimin e të ardhurave financiare.

Si u hap bota përpara teje? Çfarë ndodhi në dhjetë muajt e fundit?

Guxoj të besoj në ëndrrat dhe objektivat e mija, dhe kështu mësoj edhe fëmijët. Edhe si femër kam ndryshuar shumë, sepse pas lindjes së katër fëmijve mbeta mbi peshë, gjë që nuk munda ta pranoja. Tani e ndjej, që kam filluar ti shoh gjërat ndryshe në lidhje edhe me veten. Jam e zonja e vetes, mund të shtoj financën me të ardhurat plus që derdhen në arkën familjare.

Kush janë bashkpuntorët e tu?

Linja ime e sipërme, Izabella më ndihmon shumë, dhe mund të llogarisë gjithmonë edhe ndihmën e Zsolt Feketes, njërit prej krijuesve të Eagle Team-it. Për një kohë të mirë isha „sipërmarrëse individuale“, desha të provoja veten, por tashmë ka filluar të krijohet grupi im i vogël. Tani arrita të kuptoj atë, që besoj: mund të ndihmoj edhe të tjerët.

Për ku më tej?

Për këtë vit kam si objektiv arritjen e nivelit të Eagle Managerit, si dhe Chairman's Bonusin.

Me siguri këtë artikull do ta lexojnë edhe ato, që janë në të njëjtën situatë si ti: prej kohësh janë në shtëpi dhe edukojnë fëmijët. Çfarë mesazhi do t'ju jepje atyre?

Nëse dikush ka fëmijë, atëhere ai ka edhe një sistem shumë të gjerë lidhjesh: këto janë marrëdhëniet e prindërve në kopshte, shkolla etj. Nëse personi apo fëmija merret edhe me sport, atëhere edhe nga andej do të ketë shumë të njohur. Mendoj, që ndërtimi i rrjetit në Forever, është e vetmja formë sipërmarrje, që është e pajtueshme me familjen. Tek ne sporti është jashtzakonisht i rëndësishëm, fëmijët ikin në stërvitje, nëpër gara, por me një organizim të mirë, gjithmonë e kemi zgjidhur që të mbetet kohë për prezantime. Nëse për mua ka qënë e mundëshme, atëhere edhe për të tjerët duhet të jetë.

Sa kohë i kushtove sigurimit të nivelit të menaxherit?

Ndoshta dy muajt e parë ishin më të sforcuarat; pushimet e verës ishin të mbushura në vazhdimësi me prezantime. Me bashkpuntorët mbanim katër-pesë prezantime në javë, pothuaj nga një në ditë.

Cila është receta jote?

Duhet provuar produktet, sepse duhet eksperiencia personale. Nëse dikush do të jetë vetëm përdorues produktesh, pra nuk fillon biznesin, edhe atëhere ka bërë shumë për veten. Këtu askush nuk ka çfarë të humb, sepse mund të marrë vlerësim, mund të fitojë miq dhe mund të përfitojë edhe financiarisht. Mua kjo atmosferë më ngroh, dhe këtu përfitoj shumë gjëra pozitive. Kam fëmijë të lumtur e të shëndetshëm, edhe jeta familjare është në harmoni, e ekuilibruar, e cila më bëri edhe mua të kënaqur. Foreveri më dha mua ëndrra dhe qëllime të reja, e besoj, që ka më tej, ka më tej edhe pas asaj, që të rris fëmijë të lumtur. E rëndësishme është, që të jem nënë e mirë dhe shoqe e mirë për bashkëshortin, i cili gjithmonë është pranë meje dhe më përkrah, që të arrij objektivat që i kam vënë vetes.



KAMPINGU HIPIZMIT NË KËSHTJELLËN E SZIRAKUT

“Një kal edhe pa kalorës është kal,
por kalorësi pa kal është një njeri i thjesht.”

Do dëshiroje edhe ti të jesh kalorës?

Kalo me ne në pushimet e verës një javë të paharruar dhe
do të kesh mundësi të shijosh bukurinë e jetës me kuaj,
qëndrimin në kal dhe kalërimin !

ORARET E KAMPINGUT TË HIPIZMIT (6 DITË/5 NETË):

- turni I: nga 05 korrik deri në 10 korrik 2013
- turni II: nga 12 korrik deri në 17 korrik 2013
- turni III: nga 21 korrik deri në 26 korrik 2013
- turni IV: nga 04 gusht deri në 09 gusht 2013
- turni V: nga 11 gusht deri në 16 gusht 2013

Çmimi i kampit ditor me kuaj bashkë me drekën: 5.900 Ft/person/ditë

Çmimi i kampit me fjetje, me trajtim të plotë: 14.500 Ft/person/ditë

Turnet javore do ti nisim po të ketë të paktën 6 kandidatë!

Informacione të mëtejshme: Teleki-Degenfeld Kastély Szálló Szirák

3044 Szirák, Petőfi út 26. Tel.: +36-32-485-300

E-mail: info@kastelyszirak.hu,

Web: www.kastelyszirak.hu



Success Day

2013. 07.20.



DREJTUES PROGRAMI: **ISTVÁN HALMI DHE RITA MIKOLA HALMINÉ**
Diamant-Safir Menaxherë



PËRSHËNETJE
DR. SÁNDOR MILESZ
Drejtör vendor



ËNDRAT MUND TË ARRIHEN
GERGELY ALMÁSI DHE BARBARA BAKOS
Menaxherë



MBROJTJA E SHËNETIT GJATË VERËS
DR. BOGLÁRKA FRANCIA
mjeke shtëpie, terapiste familjare, Menaxhere



FOREVER PARTNER'S BUSINESS CLUB
TIBOR RADÓCZI
Soaring Menaxher



NDËRTIMI I TË ARDHMES
DR. ILONA JURONICS VARGÁNÉ & GÉZA VARGA
Soaring Menaxherë



SHËNETI APO PARA? ME FOREVERIN NUK ËSHTË E
NEVOJSHME TË SAKRIFIKOSH NJËRËN PËR TJETRËN.
RÓBERT VARGA
Diamant-Safir Menaxher

KUALIFIKIMI I SUPERVIZORËVE DHE ASISTENT MENAXHERËVE
KUALIFIKIMI I KLUBIT TË CONQUISTADORËVE DHE MENAXHERËVE,
DORËZIMI I TARGAVE TË AUTOVETURAVE, KUALIFIKIMI I
MENAXHERËVE TË LARTË,

FOREVER

IMRPRESSUM


Botues: Forever Living Products Hungari Shpk. **Redaksia:** FLP Hungari Shpk. 1067 Budapest, Szondi u. 34. Telefon: (36-1) 269-5373 Fax: (36-1) 312-8455

Kryeredaktor: Zsuzsanna Petroczy Redaktor: Valeria Kismarton, Kalman Posa, Sandor Rokas,

Layout, përgatitje për shtypje: Crossroad Consulting Shpk. **Përkthim, redaktim:** Mimoza Borbáth, Xhelo Kicaj (shqip), Babity Gorán Vladimir, Žarko Anić Antić (kroat), Babity Gorán Vladimir, Dragana Meseldžija (serb), Jolanda Novak Csaszar, Biro 2000 Ljubljana (slloven). **Shtypshkronja:** Palatia Nyomda és Kiadó Shpk.

U përgatit në 30500 kopje. Për përmbajtjen e artikujve përgjegjësia është e autorëve. Çdo e drejtë mbrohet!

www.foreverliving.com



flawless^{by}
*Senya*TM